

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5735  
E martë, 26 mars 2019  
çmimi 0.40 €

## SBASHK-u paralajmëron grevë për shkak të kërkesës për kompensimin e orëve

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", FLORIAN DUSHI | FAQE 4-5

## PAN-i, LDK-ja dhe LV-ja duhet t'i kenë nga dy anëtarë në KQZ

Ish-anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nga radhët e LDK-së, Florian Dushi, ka bërë me dije se përfaqësimi i subjekteve politike në këtë komision duhet të ndodhë sipas formulës së deritashme kushtetuese. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Dushi ka thënë se presidenti Thaçi duhet të vendosë që anëtarë të KQZ-së t'i emërojë dy zyrtarë të koalicionit PAN, dy të Vetëvendosjes dhe dy të LDK-së. Sipas tij, përfaqësimi në KQZ nuk bëhet në bazë të dëshirës së subjekteve politike, por sipas Kushtetutës së Kosovës



### AKTUALE

#### PRESIDENTI META, REFERENCË KUSHTETUESE DHE EKULIBRI POLITIK F. 10

Prof. Lisen BASHKURTI



#### PAVARËSIA E KOSOVËS DHE VEPRIMTARËT ILEGALË TË LËVIZJES KOMBËTARE F. 11

Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA



#### SHËNOHET 20-VJETORI I MASAKRËS NË FSHATRAZ CELINË, FORTESË E BRESTOC TË RAHOVECIT F. 5

#### VESELI: DHUNA NDAJ FËMIJËVE DHE NDAJ GRAVE NUK DUHET TOLERUAR ASNJËHERË F. 5



### EKONOMI

#### HARADINAJ: DUHET TË KTHEHEMI NË NJË KOMB INOVATIV NË EKONOMI F. 8

#### BQK-ja HAP JAVËN NDËRKOMBËTARE TË PARASË ME QËLLIM TË EDUKIMIT FINANCIAR F. 6

## DAKA: PARTITË POLITIKE DUHET TA KENË PARASYSH INTEGRITETIN E KANDIDATËVE NË ZGJEDHJE

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka thënë se subjektet politike duhet ta kenë parasysh integritetin e kandidatëve në zgjedhje. Ajo ka deklaruar se është në dorën e partive nëse dëshirojnë të nominojnë apo jo persona të ndjekur për vepra penale. Këto komente Daka i ka bërë në tryezën me temë "Procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve të partive politike në Britani të Madhe" të organizuar nga Fondacioni Westminster për Demokraci | FAQE 3



nga Fondacioni Westminster për Demokraci | FAQE 3

KOSOVË 1 - 1 BULLGARI

## Kosova dominon ndaj Bullgarisë, mungon vetëm fitorja

FAQE 14



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Vrasësi i Donjeta Pajazitit dënohet me burgim të përjetshëm

PEJË, 25 MARS - Gjykata Themelore në Pejë ka dënuar Naser Pajazitajn me burgim të përjetshëm. Naser Pajazitaj është akuzuar se ka vranë kushëriën e tij 22-vjeçaren Donjeta Pajazitaj në Bjeshkët e Strelcit. Të pandehurit i është caktuar masa e paraburgimit deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit. "I pandehuri N.P. shpallet fajtor për shkak se më 9 nëntor 2015,

në Bjeshkët e Strelcit, të komunës së Deçanit në vendin e quajtur të 'Kroni i Lajthisë', i pandehuri, duke qenë edhe më parë i dënuar për vepër penale të vrasjes së rëndë, me dashje dhe me armë të tipit të panjohur, në mënyrë dinake e ka privuar nga jeta viktimën D. P., me çka ka kryer veprat penale vrasje e rëndë dhe armëmbajtje pa leje", është thënë në njoftimin nga

Gjykata e Pejës. Gjykata deri te kjo gjendje faktike ka ardhur pas nxjerrjes së provave të reja që kanë munguar më parë dhe se këto prova të reja në lidhshmëri me prova të tjera e dëshmojnë se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit.



## Shkupi i kërkon ndihmë Prishtinës për zbatimin e Ligjit për shqipen

Zëvendëskryeministri i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, ka thënë se për zbatimin e drejtë të gjuhës shqipe, si gjuhë zyrtare në institucionet e Maqedonisë së Veriut, do të kërkohej ndihmë edhe nga Shqipëria dhe veçanërisht nga Kosova si vend ku me sukses funksionon dygjuhësia gjatë komunikimit të institucioneve me qytetarët



SHKUP, 25 MARS - Deri në konsolidimin e organeve që do të angazhohen për zbatimin e drejtë të gjuhës shqipe, si gjuhë zyrtare në institucionet e Maqedonisë së Veriut, përkthimet do të bëhen nga administratorët shqiptarë të cilët nuk janë përkthyes profesionalë, ka bërë të ditur zëvendëskryeministri i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani.

Ai duke u arsyetuar rreth gabimeve të shumta gjatë përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe nga ana e institucioneve shtetërore, tha se gjatë periudhës transitore shfrytëzohet për ngritjen e kapaciteteve me kuadër profesional që do t'i bëjnë

përkthimet.

"Mos të harrojmë se kemi një periudhë parapërgatitore prej gjashtë muajve për të krijuar kapacitete brenda institucioneve për zbatimin Ligjit për gjuhët", tha ai.

"Por, ajo që është brenda dy muajve të parë sa ka hyrë në fuqi ligji është për t'u përgëzuar", ka thënë Osmani, duke bërë të ditur se do të kërkohej ndihmë edhe nga Shqipëria dhe veçanërisht nga Kosova si vend ku funksionon, siç tha, me sukses dygjuhësia gjatë komunikimit të institucioneve me qytetarët.

"Do të duhet të krijojmë komu-

nikime për shkak se edhe Kosova është specifike sa i përket dygjuhësisë dhe mund të na ndihmojë shumë në aspektin e përgatitjes së formatit të dokumenteve si dhe angazhimin e përkthyesve", tha ai.

"Në këtë edhe Shqipëria si shtet mund të na ndihmojë në aspektin e shërbimeve profesionale sa i përket aspektit gjuhësor kështu që nuk do të lëmë hapësirë pa shfrytëzuar për ta vënë në jetë sa më parë me kapacitet të plotë këtë

ligj", ka thënë Osmani.

Ndërkaq, Ylber Sela, i cili drejton Agjencinë për Zbatimin e Ligjit për përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe, ka bërë të ditur se konkursi për punësimin e kuadrit të ri në diktatorin që ai drejton do të hapet menjëherë sapo të ketë përfunduar procesi për zgjedhjen e kryetarit të shtetit.

"Të gjitha kërkesat që vijnë nga institucionet e ndryshme të shtetit sa i përket përkthimit u jemi përgjigjur në gatishmëri të

plotë", ka thënë Sela.

Ndërkaq, sekretari i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, Dragi Rashkoski, ka sqaruar se me qëllim që të fillojë zbatimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve, një pjesë e administratorëve shqiptarë të angazhuar në sekretariatit për zbatimin e marrëveshjes së Ohrit, do të kalojnë në Agjencinë për zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

"Bëhet fjalë për persona që tashmë kanë një lloj përvojë në angazhimin në administratën e shtetit dhe vlerësojmë se kapacitetet e tyre, do të kontribuojnë në këtë Agjenci", tha Dragi Rashkovski.

Ndryshe problem me shfaqjen e shumë gabimeve në mbishkrimet e institucioneve u shfaq menjëherë pasi në fuqi hyri Ligji për përdorimin e gjuhëve me ç'rast krijohet një shtrirje më e gjerë e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në institucionet e shtetit.

## Trumpi njuh sovranitetin e Izraelit mbi Rrafshnaltën e Golanit

WASHINGTON, 25 MARS - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, e njohu sovranitetin e Izraelit mbi Rrafshnaltën e Golanit - rajon të cilin forcat izraelite e kanë pushtuar nga Siria në fazat e fundit të Luftës Gjashtëditëshe të vitit 1967. Duke nënshkruar njohjen zyrtare në Shtëpinë e Bardhë,



Trumpi tha se ShBA-ja është dashur ta bëjë një hap të tillë "disa dekada më parë".

Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, qëndroi pranë Trumpit në Shtëpinë e Bardhë derisa ai e nënshkroi njohjen.

Netanyahu tha se kjo është një "ditë historike që i transformon fitoret ushtarake të Izraelit në Rrafshnaltën e Golanit në fitore diplomatike".

Netanyahu, po ashtu, tha se

njohja nga Trumpi e bën aleancën midis Izraelit dhe Amerikës "më të fortë dhe më të madhe se kurrë".

Më herët, Siria deklaroi se është e vendosur të rimarrë Rrafshnaltën e Golanit përmes të gjitha mjeteve në dispozicion. Rrafshnaltë Golan ndodhet rreth 60 kilometra në jugperëndim të kryeqytetit të Sirisë, Damask,

dhe mbulon rreth 1,200 kilometra katrorë.

Në vitin 2017, Trumpi e njohu edhe Jerusalemin si kryeqytet të Izraelit dhe urdhëroi zhvendosjen e Ambasadës amerikane atje nga Tel-Avivi.

Ky vendim u dënua nga palestinezët, të cilët e duan Jerusalemin Lindor për kryeqytet të shtetit të ardhshëm palestinez.

## Basha: Të përgatitemi për zgjedhje të parakohshme



TIRANË, 25 MARS - Pavarësisht deklaratave se nuk ka zgjedhje me Ramën kryeministër, kreu i PD-së, Lulzim Basha u bën thirrje të tije që krahas protestave të përgatiten edhe për zgjedhje të parakohshme.

Në mbledhjen e zhvilluar në selinë blu, me ish-grupin parlamentar dhe kryesinë e PD-së, Basha u bëri thirrje që të ketë një organizim sa më të mirë për protesta masive. Burimet, po ashtu, bëjnë me dije se kreu i PD-së ka kërkuar nga ta që të

jenë më aktivë, e të mos rrinë në kafe ditën e protestave, por të dalin në ballë të saj.

"Të jeni më aktivë. Takime me qytetarët në terren për protestat që na presin. Intesifikojini takimet me qytetarët. Protesta çdo të enjte

para, angazhim serioz për protestën kombëtare të 13 prillit. Nuk keni qenë prezentë sa duhet. Duhet të jeni më aktivë. Nuk duhet të rini në kafe me njëri-tjetrin, por në ballë të protestës", është shprehur Basha.



# Daka: Partitë politike duhet ta kenë parasysh integritetin e kandidatëve në zgjedhje


Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka thënë se subjektet politike duhet ta kenë parasysh integritetin e kandidatëve në zgjedhje. Ajo ka deklaruar se është në dorën e partive nëse dëshirojnë të nominojnë apo jo persona të ndjekur për vepra penale. Këto komente Daka i ka bërë në tryezën me temë "Procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve të partive politike në Britani të Madhe" të organizuar nga Fondacioni Westminster për Demokraci



votuesit si dhe për demokracinë në përgjithësi. "Kandidatët të cilët partia politike i përzgjedhë janë fytyra e partisë. Ky është një proces shumë kompleks pasi gjithë mandatin e ardhshëm do të mbështeten në këta persona. Mund ta ndihmojmë Kosovën në këtë proces në mënyrë që të lulëzojë demokracia brenda partive dhe të ketë kandidatë të aftë për t'i kryer përgjegjësitë e veta", ka theksuar ai.

Kurse profesoresha nga Universiteti Exter në Britani të Madhe, Jo Silvester, ka vlerësuar se përzgjedhja e kandidatëve është një nga funksionet më të rëndësishme të një organizate demokratike dhe mekanizmi

primar nëpërmjet të cilit partitë politike vendosin nëse një individ ka cilësitë e nevojshme për t'u bërë përfaqësues i zgjedhur. "Përzgjedhja e kandidatëve politikë në përgjithësi ka të bëjë me aftësinë e një partie politike për të tërhequr, miratuar dhe zgjedhur një grup individësh të talentuar që do jenë tërheqës për votuesit dhe të mbeten besnikë ndaj vlerave të partisë politike", është shprehur Silvester, duke shtuar se subjektet politike mund të fitojnë avantazhe duke konsiderueshme duke hartuar procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve të ndërtuara mbi konceptin e kompetencës politike.

EPOKA  
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 25 MARS - Integriteti i kandidatëve në zgjedhje është një aspekt i rëndësishëm sepse ndikon në organizimin e procesit zgjedhor. Kështu është thënë të hënën në tryezën me temë "Procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve të partive politike në Britani të Madhe" të organizuar nga Fondacioni Westminster për Demokraci. Me këtë rast kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, ka thënë se është në dorën e partive politike nëse dëshirojnë të nominojnë apo jo persona të ndjekur për vepra penale. Megjithatë, ajo ka theksuar se subjektet politike duhet ta kenë parasysh integritetin e kandidatëve në zgjedhje meqë, sipas Dakës, kjo ndikon në procesin zgjedhor. "Sa i përket përzgjedhjes së kandidatëve të partive politike që është edhe temë e kësaj punëtorie, kemi miratuar

edhe rregullin për regjistrimin dhe veprimin e partive politike përmes së cilës kemi rregulluar procedurat për regjistrimin e partive politike. Kemi vendosur standardet demokratike të cilat duhen plotësuar nga subjektet politike. Sot të gjitha subjektet politike të regjistruara në Kosovë i kanë të normuara procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve të cilët marrin pjesë në zgjedhje. Me këto dispozita të rregullës zgjedhore jemi përkujdesur që secili anëtar i partisë politike të dijë paraprakisht se si mund të bëhet kandidat dhe nëpër cilat procedura duhet të kalojë. Një aspekt i rëndësishëm në këtë drejtim është marrja parasysh e integritetit të kandidatëve pasi ndikon në organizim e zgjedhjeve. Tash është në dorën e partive politike që të nominojnë apo jo persona të ndjekur për vepra penale në listat e tyre", ka deklaruar Daka, duke shtuar se KQZ-ja, përveç aspekteve të organizimit të zgjedhjeve, është

përgjegjëse edhe për regjistrimin e subjekteve partive politike dhe përkujdeset që ato të veprojnë sipas standardeve demokratike të përcaktuara me ligjet dhe rregullat zgjedhore. "Në kuadër të sekretariatit të KQZ-së vepron edhe Zyra për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike. Kjo zyrë është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrimit të partive politike, certifikimin e të gjitha subjekteve politike që do të përfshihen në fletëvotim dhe kufizimin e shpenzimeve të fushatave dhe dispozitave për deklarim financiar", ka theksuar kryetarja Daka. Ndërsa shefi i seksionit për demokratizim nga Ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë, Sam Paice, ka thënë se është një mekanizëm parësor që partitë politike vendosin nëse një individ ka cilësitë e nevojshme për t'u bërë zyrtar i zgjedhur. Ai ka thënë se përzgjedhja e drejtë e kandidatëve është e rëndësishme për partitë politike, për

## Haradinaj shkarkon zëvendësministren Mikiq

PRISHTINË, 25 MARS (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka liruar nga detyra zëvendësministren e Drejtësisë, Vesna Mikiq, e cila vjen nga radhët e subjektit politik Lista Serbe. Haradinaj nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka njoftuar se ky vendim u mor pasi Mikiqi ka deklaruar se bombardimet e NATO-s mbi caqet e ish-Jugosllavisë ishin gjenocid ndaj shtetit dhe popullit serb. Sipas kryeministrit Haradinaj, deklarimet e tilla janë të papranueshme dhe përkojnë me gjuhën e urrejtjes. "Në Qeverinë dhe institucionet e Republikës së

Kosovës nuk kanë vend individët, pavarësisht prej përkatësisë etnike, që denigrojnë vlerat e përbashkëta euroatlantike, aq më tepër kur shteti i Kosovës është krijuar pikërisht në bazë të këtyre vlerave. Deklarata e zëvendësministres në Ministrinë e Drejtësisë, Vesna Mikiq, se bombardimet e NATO-s ishin gjenocid ndaj shtetit dhe popullit serb, janë të papranueshme dhe përkojnë me gjuhën e urrejtjes, që sanksionohen me Kushtetutë dhe ligj. Prandaj, sot kam liruar nga detyra zëvendësministren Mikiq", ka thënë Haradinaj.



Flet për "Epokën e re", Florian Dushi

# PAN-i, LDK-ja dhe LV-ja duhet t

Ish-anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nga radhët e LDK-së, Florian Dushi, ka bërë me dije se përfaqësimi i subjekteve politike në këtë komision duhet të ndodhë sipas formulës së deritashme kushtetuese. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Dushi ka thënë se presidenti Thaçi duhet të vendosë që anëtarë të KQZ-së t'i emërojë dy zyrtarë të koalicionit PAN, dy të Vetëvendosjes dhe dy të LDK-së. Sipas tij, përfaqësimi në KQZ nuk bëhet në bazë të dëshirës së subjekteve politike, por sipas Kushtetutës së Kosovës



**EPOKA E RE** **Muhamet KOÇI**

**PRISHTINË, 25 MARS** - Ish-anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Florian Dushi, e ka vlerësuar të paprecedent mosfunksionalizimin e KQZ-së deri më tani. Ai ka thënë se përfaqësimi i subjekteve politike në këtë institucion të pavarur nuk duhet të ndodhë mbi bazën e dëshirës së partive, por mbi bazën e Kushtetutës së Kosovës. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Dushi ka thënë se

presidenti i vendit, Hashim Thaçi, duhet të veprojë sipas formulës së njohur deri më tani. "Kjo nuk mund të trajtohet si dëshirë apo vullnet i subjekteve politike. Kemi tri subjekte politike që kanë dalë nga zgjedhjet e fundit nacionale: koalicionin PAN,

Lëvizjen Vetëvendosje dhe koalicioni që e udhëheq LDK-ja. Kështu që, gjashtë vendet e parapara për komunitetin shumicë shqiptar në këtë institucion duhet të ndahen në mes të këtyre tri subjekteve politike, që nënkupton se secila prej tyre duhet t'i këtë nga dy për-

faqësues", ka thënë Dushi. Ai i ka ftuar subjektet politike që ta lënë të qetë presidentin e Kosovës në zbatimin e formulës kushtetuese që e kemi para vetes. Dushi ka vlerësuar se presidenti i vendit është dashur të veprojë në funksionalizimin e KQZ-së menjëherë

pas zgjedhjeve të përgjithshme nacionale, të cilat janë mbajtur në qershor të vitit 2017. Sipas tij, shefi i shtetit e ka obligim kushtetues funksionalizimin e institucioneve kushtetuese. "Atëherë është dashur të veprojë presidenti dhe t'i emërojë anëtarët e KQZ-së në

## Shënohet 20-vjetori i masakrës në fshatrat Celinë, Fortesë e Brestoc të Rahovecit

**RAHOVEC, 25 MARS (ER)** - Në fshatrat Celinë, Fortesë e Brestoc të Komunës së Rahovecit sot janë mbajtur tubime përkujtimore për ta shënuar 20-vjetorin e të vrarëve gjatë vitit 1999 në këto fshatra, të cilët u vranë barbarisht nga paramilitarët serbë. Në këto tubime ka marrë pjesë edhe kryetari i komunës, Smajl Latifi, me bashkëpunëtorë dhe familjarë të të rënëve. "Sot e 20 vjet më parë, pushtuesi kriminal serb, duke mos kursyer asnjë person,

vrau barbarisht martirë dhe dëshmorë shqiptarë në Celinë, Fortesë e Brestoc. Në Brestoc u vranë 49 shqiptarë, ku gjashtë prej tyre janë të pagjetur. Qytetarët tanë u vranë dhe u masakruan veç pse ishin shqiptarë. Pastaj në Fortesë ishin 69 bashkëqytetarë tanë, të rinj e të moshuar, burra dhe gra, që mizorisht u privuan nga jeta. Njëjtë okupatori serb veproi edhe në Celinë, duke vrarë 75 persona, në një masakër që tronditi gjithë botën",

ka thënë kryetari Latifi. Në fjalimin e tij kryetari Latifi ka vazhduar duke thënë se i kujtojnë me nder, respekt dhe përlulje të thellë të gjithë burrat, gratë, pleqtë e fëmijët që u ekzekutuan barbarisht nga makineria vrastare e pushtuesit serb. "Jeta, vepra dhe gjaku i të rënëve janë baza dhe themeli i lirisë së Kosovës. Presim që të vendoset drejtësia e vonuar dhe të marrin dënimin e merituar kriminelët që na lanë pa më të dashurit tanë", ka thënë Latifi.





# 'i kenë nga dy anëtarë në KQZ



presidenti të ndërmarrë veprime të duhura sa më parë, ashtu siç parashihet me Kushtetutën e Kosovës. Përndryshe, subjektet politike, siç e kanë thënë edhe më parë, janë të gatshme që çështjen ta referojnë edhe pranë Gjykatës Kushtetuese, që është institucioni i vetëm përgjegjës për të ofruar mbrojtje kushtetuese në raste të ngjashme", ka thënë Dushi.

**"Epoka e re":** Z. Dushi, Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur ta miratojë një rezolutë për funksionalizimin e KQZ-së. Cili është vlerësimi juaj rreth kësaj çështje?

**Dushi:** Mbatja e asaj seance ka qenë me vend, sepse ajo ka qenë rrjedhojë e një shqetësimi të subjekteve politike për bllokimin e një institucioni vital të Republikës së Kosovës, siç është KQZ-ja. Kam pasur rastin ta shoh përmbajtjen e asaj rezolute dhe ajo ka pasur një kërkesë që i drejtohej presidentit të vendit, si personi kompetent dhe përgjegjës, për funksionalizimin e KQZ-së. Nuk ishte diçka që subjektet politike do të duhej të hezitonin ta mbështesnin atë dokument.

**"Epoka e re":** Si do të duhej të vepronte presidenti i vendit tani për ta funksionalizuar KQZ-në?

**Dushi:** Presidenti është dashur të veprojë qysh para një viti, menjëherë pas zgjedhjeve të përgjithshme nacionale, të cilat janë mbajtur në qershor të vitit 2017. Pra, atëherë është dashur të veprojë presidenti dhe t'i emërojë anëtarët e KQZ-së në përputhje me rezultatin e atyre zgjedhjeve, siç kërkohet nga Kushtetuta e Kosovës dhe siç kërkohet nga Ligji për zgjedhjet e përgjithshme. Edhe pas kësaj kohe, mbetet e njëjta pengesë. Mendoj se presidenti i Kosovës duhet të veprojë me

shpejtësi në kuptimin e funksionalizimit të këtij institucioni kaq të rëndësishëm për vendin.

**"Epoka e re":** Debati kryesor që po zhvillohet rreth kësaj çështje ka të bëjë mënyrën e përfaqësimit të partive politike në këtë institucion. Si duhet të jetë ky përfaqësim?

**Dushi:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nuk ndërtohet mbi bazën e kërkesave apo të dëshirave të partive politike. KQZ-ja ndërtohet mbi bazën e një formule që është dhënë në Kushtetutën e Kosovës, e cila bazohet në rezultatin e zgjedhjeve. Në verdiktin e Gjykatës Kushtetuese të dhënë para pak kohe në lidhje me atë se çfarë nënkuptohet me grupin parlamentar dhe shumë aspekte të tjera që janë shumë më tepër juridike dhe aspak politike, është sqaruar kjo çështje. Prandaj, subjektet politike duhet të jenë në respekt të Kushtetutës dhe formulës që tashmë është praktikuar në kuptimin e ndarjes së vendeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Subjektet politike duhet ta lënë të qetë presidentin e Kosovës për zbatimin e asaj formule kushtetuese që e kemi para vetes. Prandaj, po e përsëris edhe një herë, kjo nuk mund të trajtohet si dëshirë apo vullnet i subjekteve politike. Kemi tri subjekte politike që kanë dalë nga zgjedhjet e fundit nacionale: koalicionin PAN, Lëvizjen Vetëvendosje dhe koalicionin që e udhëheq LDK-ja. Kështu që, gjashtë vendet e parapara për komunitetin shumicë shqiptar në këtë institucion duhet të ndahen në mes të këtyre tri subjekteve politike, që nënkupton se secila prej tyre duhet t'i ketë nga dy përfaqësues.

**"Epoka e re":** Ky bllokim i

KQZ-së sa po ndikon në mbarëvajtjen e punës së këtij institucioni. Cilat janë pasoja e mosfunksionalizimit të këtij institucioni?

**Dushi:** E kam thënë disa herë, se mosfunksionalizimi i KQZ-së është një precedent i rrezikshëm për jetën parlamentare në Kosovë dhe për demokracinë në vendin tonë. Kurse, pasoja është më tepër teknike/organizative, ku kemi dhjetëra asamblastë nëpër gjithë Kosovën që presin me muaj të tërë të zëvendësohen, po ashtu kemi edhe një deputet në Kuvendin e Kosovës që pret të zëvendësohet. Pra, kemi mosfunksionim në kuptimin e detyrave të tjera që duhet të zhvillohen brenda KQZ-së, siç është ndarja e fondit për subjektet politike, që ka ndikuar drejtpërdrejt në stagnimin e shumë proceseve brenda subjekteve politike. Prandaj, po them se pasojat janë të rënda me mosfunksionalizimin e KQZ-së, mbi të gjitha në kuptimin politik dhe juridik. Kjo është diçka e paprecedent që presidenti nga roli i tij për ta mbikëqyrë dhe garantuar funksionimin demokratik të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë, shndërrohet në personin i cili praktikisht nuk po e bën funksionalizimin e këtij institucioni deri më tani.

**"Epoka e re":** Në bazë të rrethanave të krijuara, kur pritni që presidenti ta bëjë funksionalizimin e këtij institucioni?

**Dushi:** Natyrisht, ne presim që presidenti të ndërmarrë veprime të duhura sa më parë, ashtu siç parashihet me Kushtetutën e Kosovës. Përndryshe, subjektet politike, siç e kanë thënë edhe më parë, janë të gatshme që çështjen ta referojnë edhe pranë Gjykatës Kushtetuese, që është institucioni i vetëm përgjegjës për të ofruar mbrojtje kushtetuese në raste të ngjashme.

përputhje me rezultatin e atyre zgjedhjeve, siç kërkohet nga Kushtetuta e Kosovës dhe siç kërkohet nga Ligji për zgjedhjet e përgjithshme. Edhe pas kësaj kohe, mbetet e njëjta pengesë. Mendoj se presidenti i Kosovës duhet të veprojë me shpejtësi në kuptimin e funk-

sionalizimit të këtij institucioni kaq të rëndësishëm për vendin", është shprehur ai. Dushi ka paralajmëruar se nëse nuk vepron presidenti Thaçi në këtë drejtim, opozita pritet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për këtë çështje. "Natyrisht që ne presim që

## Hoxhaj viziton Shoqatën e të Verbërve, interesohet për kërkesat e tyre

PRISHTINË, 25 MARS (ER) - Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka vizituar të hënën Shoqatën e të Verbërve të Kosovës, me drejtuesit e së cilës ka biseduar rreth mbështetjes së Qeverisë së Kosovës për kërkesat e tyre. Hoxhaj ka bërë me dije se ndër kërkesat kryesore ishte sin-teza vokale në gjuhën shqipe, e cila lehtëson në masë të madhe

komunikimin dhe informimin e tyre në shumë platforma. "Pas miratimit nga Qeveria e Kosovës, e vendimit për përkthimin e infrastrukturës ligjore në alfabetin e brajlit, atyre u premtova se shumë shpejt do të realizojmë çdo kërkesë në mënyrë që të bëjmë sa më të lehtë dhe të sigurt jetesën e tyre në shoqërinë tonë", ka thënë Hoxhaj pas takimit.





## Nis rrënimi i lokaleve në qendër të qytetit të Deçanit

DEÇAN, 25 MARS (ER) - Të hënën që qendër të qytetit të Deçanit ka filluar largimi i lokaleve të cilat do të zëvendësohen me hapësira gjelbëruese si dhe me këtë do të mundësohet zgjerimi i rrugës kryesore të qytetit. Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj,

ka thënë se komuna është duke vepruar konform ligjit. Ai ka thënë se pronarët janë thirrur në takime dhe janë njoftuar me kohë për të gjitha procedurat. Ramosaj ka kërkuar nga pronarët e këtyre lokaleve që të kenë mirëkuptim në zbatimin e këtij vendimi.



## Malisheva shprehet e gatshme t'i presë investitorët gjermanë

MALISHEVË, 25 MARS (ER) - Pasi Komuna e Malishevës u bë me Zonë Ekonomike, interesimi i investitorëve të huaj për të investuar ka filluar të rritet. Një interesim të tillë ka shprehur edhe investitori gjerman Patrik Jung në bashkëpunim me biznesmenin shqiptar Milaim Zogaj përmes kompanisë "Bauunternehmen GMBH" me seli në Dortmund, që me produktet e veta, në fushën e energjisë solare, të përgatitet në një të ardhme të afërme për

investime në Malishevë. Një takim i tillë u zhvillua të hënën, ku kryetari i komunës, Ragip Begaj dhe nënkryetari Hajdin Berisha priten në takim pune biznesmenin gjerman Patrik Jung dhe përfaqësuesin e kompanisë "Bauunternehmen GMBH" me seli në Dortmund, Milaim Zogaj. Begaj ka shprehur gatishmërinë që si institucione komunale t'u ofrojnë lehtësira për sigurimin e hapësirave dhe të infrastrukturës adekuate

për ta zhvilluar biznesin në fjalë. "Do t'ju ofrojmë gjithë potencialet njerëzore që kemi, me qëllim të rritjes së mirëqenies ekonomike për qytetarët tanë", ka thënë Begaj. Investitorët kërkuar partneritet publiko-privat për arsye të sigurisë më të mirë. Në këtë takim u bë me dije se të dyja palët të fillojnë përgatitjen e dokumenteve dhe procedurat e nevojshme ligjore për ta parë mundësinë e investimeve.



## Lladrovci inspekton punimet për ujësjellësin te pishat e Gllobarit

Drenas, 25 mars (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka vizituar lokacionin te pishat e Gllobarit, për të parë nga afër punën e kryer nga qytetarët vullnetarë për pastrimin e kësaj zone me shumë potencial turistik. Njëkohësisht Lladrovci ka inspektuar edhe punimet e kryera për ujësjellësin si pjesë e projektit "Ndërtimi i kapacitetit

të ujësjellësit në Kamenicë" me punëkryes "Diamanti" sh.p.k. Gjatë këtij inspektimi, Lladrovci ka vërejtur se punimet nuk janë kryer sipas standardeve dhe paramasave të planifikuara pasi, sipas tij, është duke munguar rëra mbrojtëse e gypit. Sipas Lladrovci, në shumë vende gypi ishte i vendosur mbi gurë si dhe thellësia mbi gyp nuk i kalonte 30 centimetra,

thellësia e kanalit arrinte deri në 55 centimetra e që është shumë larg nga ajo që parashihet me kontratë (80 centimetra). Me këtë rast, kryetari Lladrovci ka kërkuar nga menaxheri i projektit që t'i marrë masat dhe që punëkryesi t'i evitojë parregullsitë në punime me kohë, përndryshe do të merren masat ndëshkuese ndaj kompanisë siç parashihet me kontratë.

## Muharremaj: Nuk do të ketë kompromis për respektimin e ligjit

SUHAREKË, 25 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, është takuar me përfaqësuesit e Drejtorisë së Inspeksionit të kësaj komune, me të cilët ka diskutuar për aktivitetet e kësaj drejtorie. Me këtë rast, Muharremaj ka kërkuar angazhim maksimal dhe asnjë

kompromis për ata që e shkelin ligjin. "Në takimin me Drejtorinë e Inspeksionit kam kërkuar më shumë angazhim, ngaqë punët në terren e kërkojnë një gjë të tillë. Nuk do të ketë kompromis në asnjë segment për respektimin e ligjit", ka thënë Muharremaj pas takimit.





# SBASHK-u paralajmëron grevë për shkak të kërkesës për kompensimin e orëve

Sindikata e Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e Kosovës (SBASHK), përmes një shkresë drejtuar kryetarëve të komunave të Kosovës, ka kërkuar që të mos respektohet vendimi i Ministrisë së Arsimit për kompensimin e orëve mësimore, të humbura gjatë grevës së mësimdhënësve, e cila ka nisur më 14 janar dhe ka zgjatur tri javë. SBASHK-u ka paralajmëruar se nëse vazhdohet me vendimin për kompensimin e orëve atëherë do të shpallë grevë të përgjithshme në arsim

**EPOKA  
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 MARS - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK) u ka dorëzuar një shkresë kryetarëve të komunave të Kosovës për shkak të kërkesës ndaj drejtorëve të shkollave për kompensimin e orëve të humbura. SBASHK-u në këtë shkresë ka bërë me dije se është duke e përcjell me kujdes situatën në institucionet arsimore të Kosovës, ku theksohet se një pjesë e drejtorëve të arsimit dhe të drejtorëve të shkollave kanë nisur t'i shtojnë presionet ndaj mësimdhënësve, në përpjekje për ta vënë në zbatim vendimin e ministrit Shyqyri Bytyqi për kompensimin e orëve të humbura, i cili vendim, sipas SBASHK-ut, nuk ka bazë ligjore dhe ndaj tij është ngritur padi në gjykatë.

Në këtë shkresë, SBASHK-u ka theksuar se situata e krijuar duhet të zgjidhet me dialog dhe jo me presione e urdhra, për faktin se,

sipas tyre, me veprime të tilla vetëm sa mund të përkeqësohet situata në arsim. "Duke parë se javët e fundit është bërë një çrregullim i madh i procesit arsimor në disa komuna të Kosovës, e këtë çrregullim e ka krijuar vendimi i ministrit Shyqyri Bytyqi për zëvendësimin e orëve të humbura gjatë grevës, SBASHK-u si përfaqësuese i punonjësve të arsimit të komunave tuaja, duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin mbi organizimin sindikal nr. 04/L-011, Ligjin mbi grevën nr. 03/L-200 dhe statutin e SBASHK-ut, si dhe kontratën kolektive të arsimit nënshkruar nga MASHT-i dhe SBASHK-u, më 18. 4. 2017, ndiejmë për obligim që t'ju drejtohem me këtë shkresë, duke pasur parasysh se të gjithë drejtorët e drejtorive arsimore janë të emëruar nga ju dhe normalisht për punën e tyre duhet t'ju raportojnë juve. Gjithashtu, edhe drejtorët e shkollave ishte dashur t'i raportojnë nivelit komunal. Ditët e fundit

një pjesë e tyre kanë ndërmarrë një fushatë të presionit të mësimdhënësve për t'i detyruar që t'i zëvendësojnë orët e humbura gjatë grevës e duke u mbështetur në vendimin e MASHT-it, të cilin vendim SBASHK-u e ka kontestuar dhe e ka dërguar në gjykatë për ta vlerësuar ligjshmërinë e tij sepse ne vlerësojmë me të drejtë se është vendim i pabazuar në ligj, pasi asnjë ligj apo dokument juridik valid i Republikës së Kosovës e as normë ndërkombëtare nuk ekziston që thotë se orët e humbura gjatë

grevës duhen zëvendësuar", thuhet në këtë shkresë. SBASHK-u në shkresën zyrtare drejtuar kryetarëve të komunave thekson se nëse ky presion në disa komuna vazhdon edhe gjatë këtyre ditëve, por edhe gjatë pushimit pranveror, atëherë SBASHK-u mund të shpallë grevë të përgjithshme duke kërkuar tërheqjen e vendimit për zëvendësimin e orëve si dhe përgjegjësinë ndaj atyre që kanë ushtruar presion. "Kjo grevë mund të prodhojë edhe ditë të tjera të humbura të mësimi,

përveç këtyre 15 ditëve që janë humbur gjatë grevës", është thënë në shkresën e SBASHK-ut drejtuar kryetarëve të komunave. Mësimdhënësit kanë hyrë në grevë duke kërkuar që me koeficientin e ri të pagave, pagesat e tyre të rriten deri në 30 për qind. Greva është ndërprerë pasi drejtuesit e SBASHK-ut kanë arritur marrëveshje me drejtuesit e institucioneve, që kërkesa e tyre të përfshihet në Ligjin e pagave. Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin e pagave në sektorin publik në muajin shkurt.

## Veseli: Dhuna ndaj fëmijëve dhe ndaj grave nuk duhet toleruar asnjëherë

**EPOKA  
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 MARS - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se nëpërmjet mënyrës se si i trajtojmë sot fëmijët, shpërfaqet edhe vizioni ynë për të ardhmen. Këto komente kryeparlamentari Veseli i bëri të hënën me rastin e lansimit të fushatës së Ndalimit të

Ndëshkimit Trupor dhe Dhunës ndaj Fëmijëve, organizuar nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione, në bashkëpunim me partnerët mbështetës të komisionit, organizatat "Save the Children" në Kosovë dhe "Syri i Vizionit". Kryetari i Kuvendit ka thënë se të flasësh për të drejtat e fëmijëve do të thotë të flasësh për diçka shumë

të rëndësishme për shoqërinë tonë, duke treguar kështu se si po trajtohet e ardhmja. Ai ka theksuar se Kosova duhet të krijojë gjenerata të përgatitura të të rinjve, të cilët janë të gatshëm të përçojnë mesazhe dhe të jenë bartës të prosperitetit, inovacionit, të edukimit e të zhvillimit. "Nuk mund të paramendohet një prind i cili mund të ushtrorë dhunë ndaj fëmijës, aq

më pak në shoqërinë tonë, e cila jo më larg se dy dekada më parë i është nënshkruar një dhune sistematike dhe shkatërruese, duke lënë pasojë të cilat janë evidente edhe sot", ka thënë kryeparlamentari Veseli. Ai ka shtuar se dhuna ndaj fëmijëve dhe ajo ndaj grave nuk duhet toleruar asnjëherë. Sipas Veselit, nëse ka denoncime të tilla, atëherë

sigurisht se kemi të bëjmë me njerëz që kanë probleme dhe duhet trajtuar profesionalisht në sektorë të caktuar, përkatësisht nga psikologë dhe neuropsikiatër. "Gjeneratat e reja janë e ardhmja e shtetit tonë dhe bartëse të zhvillimit të tij, prandaj duhet t'i trajtojmë me kujdes dhe të përkujdesemi maksimalisht për to", ka deklaruar kryeparlamentari Veseli.



# BQK-ja hap javën ndërkombëtare të parasë me qëllim të edukimit financiar

Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka hapur të hënën "Javën ndërkombëtare të parasë në funksion të edukimit financiar". Në hapje të kësaj jave është nënshkruar një memorandum mirëkuptimi në mes të BQK-së dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, ka thënë se "Java ndërkombëtare e parasë në funksion të edukimit financiar" ka për qëllim krijimin e kulturës financiare. Ai ka thënë se një ndër qëllimet strategjike të BQK-së është nxitja e zhvillimit të shëndoshë të sistemit financiar në Republikën e Kosovës dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i funksionit të edukimit financiar



me BQK-në dhe i financuar nga SECO-ja, do të sjellë reforma ligjore, njohuri financiare, si dhe do të rritet efikasiteti për përdorimin e remitencave. Në anën tjetër, Patrick Etienne, drejtor i Zyrës në Kosovë i Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështje Ekonomike (SECO), është shprehur i kënaqur me mbështetjen e programit për edukim financiar dhe me BQK-në në përgjithësi, duke nënvizuar rëndësinë e projekteve të realizuara në bashkëpunim me BQK-në.

Guvernatori Mehmeti, bashkë me ministrin Bytyqi, kanë ndarë çmimet për nxënësit fitues të konkursit "Mëso, kurse, fito". Gjatë "Javës Ndërkombëtare të Parasë në funksion të edukimit financiar" që do të mbahet deri më 30 mars do të organizohen aktivitete të larmishme, duke nisur nga ligjëratat në universitetet publike dhe ato private, pastaj një ligjëratë do të mbahet në BQK me bankierët e rinj, si dhe do të organizohen edhe aktivitete me nxënës të shkollave fillore.

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 MARS - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) për të gjashtin vit me radhë ka bërë hapjen e "Javës ndërkombëtare të parasë në funksion të edukimit financiar". Në hapje të kësaj jave, guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti dhe ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi, kanë nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit me anë të të cilit BQK-ja do të shpërndajë nëpër të gjitha shkollat e Kosovës materiale të edukimit financiar përmes të cilit nxënësit e shkollave të Kosovës do ta kenë mundësinë të familjarizohen me konceptet edukative ekonomike-financiare, që është e rëndësishme të instalohen në edukimin e hershëm. Me këtë rast, guvernatori Mehmeti ka thënë se këtë vit "Java Ndërkombëtare e Parasë në funksion të edukimit financiar" ka një rëndësi të veçantë pasi, sipas tij, aktivitetet e këtij institucioni e kanë vendosur Republikën e Kosovës në vëmendjen e arenës ndërkombëtare.

Ai ka thënë se aktivitetet e kësaj jave do të mund të përcillen nga bankat qendrore, rregullatorë të ndryshëm dhe organizata ndërkombëtare, që merren me çështjet e edukimit financiar përmes transmetimit "livestream". Mehmeti ka thënë

se 2019-ta do të jetë vit i mbrojtjes së konsumatorit. "Në mjedisin e sotëm, kur të gjithë jemi dëshmitarë të qëndrueshmërisë financiare që gëzon Kosova, duke vendosur sistemin financiar të Kosovës në nivel të krahasueshëm jo vetëm me vendet e rajonit, por edhe të atyre të Unionit Evropian. Çështja e edukimit financiar ka zënë një rol të veçantë në agjendën tonë zhvillimore, aq më tepër që sektori i shërbimeve financiare ka një peshë të fuqishme në rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës, ndërtimin e infrastrukturës vitale dhe zhvillim të qëndrueshëm për Kosovën", ka deklaruar Mehmeti.

Guvernatori Mehmeti ka thënë se shërbimet dhe produktet e sektorit financiar prekin jetën e secilit qytetar të Kosovës. "Prandaj, ne u jemi mirënjohës të gjithë bashkëpunëtorëve tanë për përkrahjen që i kanë ofruar Bankës Qendrore dhe institucioneve të tjera relevante për ndërtimin e një tregu financiar, që trajton konsumatorët në mënyrë të drejtë, inkurajon përfshirjen financiare dhe ndihmon qytetarët për përdorimin efektiv të shërbimeve financiare", është shprehur Mehmeti. Ai ka thënë se një ndër qëllimet strategjike të BQK-së është nxitja e zhvillimit të shëndoshë të sistemit financiar në Republikën e Kosovës dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i funksionit të edukimit financiar, me

qëllim të krijimit të kulturës së mirëfilltë financiare, i cili, sipas tij, u ndihmon të gjitha palëve të interesit për të marrë vendime të duhura mbi bazën e njohurive të mjaftueshme.

Më tutje, guvernatori Mehmeti ka deklaruar se BQK-ja është duke zhvilluar edukimin financiar në funksion të tri dimensioneve kryesore: në funksion të stabilitetit financiar, në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve dhe në funksion të gjithë përfshirjes financiare. "Me përkrahjen e Fondit Evropian për Evropën Juglindore (EFSE) do ta realizojmë projektin 'Përmirësimi i transparencës së tregut bankar, përmes ndërtimit të Platformës për krahasimin e normave të interesit për bankat'. Kjo platformë do t'u mundësojë qytetarëve të marrin vendime mbi bazën e informatave të plota dhe të qarta, të shpalosura në një platformë të unifikuar për të gjitha bankat. Gjithashtu, kjo platformë do të ndihmojë edhe në rritjen e konkurrencës së shëndetshme në sektorin bankar. Me përkrahjen e Bankës Botërore dhe Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështje Ekonomike (SECO) kemi arritur ta dizajnojmë programin 'Greenback project' që i targeton remitencat si kategori mjaft e rëndësishme e të hyrave në Kosovë, vetëdijësimin e dërguesve dhe pranuesve të remitencave, në mënyrë që destinimi i kësaj kategorie të të hyrave të transformohet nga konsumi në

investim. Gjithashtu, Programi i remitencave dhe pagesave do ta ndihmojë BQK-në ta avancojmë tutje infrastrukturën e sistemit të pagesave, në veçanti aspektin e shtrirjes më të gjerë dhe kostos së më të volitshme për pagesat e vogla", ka deklaruar ai.

Ndërsa Marco Mantovanelli, drejtor për Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Evropë dhe Azi Qendrore i Bankës Botërore, ka thënë se programi rajonal për remitencat dhe pagesat, i nisur

## Ministri Bytyqi: Ngritja e cilësisë në arsim, prioritet yni

Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi, ka bërë me dije se kanë zyrtarizuar bashkëpunimin me Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), përmes nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit me guvernatorin e BQK-së, Fehmi Mehmeti. Me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes, Bytyqi ka theksuar se ky dokument është jashtëzakonisht i rëndësishëm, pasi bashkëpunimet e mirëfillta ndërinstitucionale i kontribuojnë realizimit të qëllimit të Ministrisë së Arsimit për arsimim dhe edukim cilësor. "Ngritja e cilësisë në arsim në vendin tonë është prioritet yni.

Si i tillë ky prioritet duhet të përkrahët nga të gjithë ne dhe një shembull i mirë është edhe arritja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Bankës Qendrore të Kosovës. MASHT-i është e gatshme të përkrahë çdo iniciativë të tillë dhe të arrijë marrëveshje mirëkuptimi edhe me partnerë të tjerë, të cilët kanë për synim zhvillimin e arsimit", ka thënë ministri Bytyqi. Ai ka falënderuar guvernatorin e BQK-së për bashkëpunimin që ka treguar edhe në kuadër të shënimit të "Javës Ndërkombëtare të Parasë në funksion të edukimit financiar".

## Ministria e Infrastrukturës financon rrugën 'A' në kryeqytet

PRISHTINË, 25 MARS (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit (MIT), Pal Lekaj, ka pritur në takim kryetarin e Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, me ç'rast kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi në përkrahje të projekteve lokale të kësaj komune. Sipas kësaj marrëveshjeje, ministria e drejtuar nga Lekaj do ta financojë rrugën "A" në kryeqytet. "Për vitin 2019, Komuna e Prishtinës nga MIT-ja, me anë të nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, mori mbështetje financiare prej 1 083 591 euro për realizimin e dy

projekteve të saj. Projekti i parë ka të bëjë me ndërtimin e rrugës 'A', i cili projekt për këtë vit përfiton 800 000 euro, ndërsa për dy vjetet në vijim janë planifikuar edhe gjashtë milionë euro, deri në përfundimin e kësaj rruge. Projekti i dytë që do të financohet nga MIT-ja është ndërtimi i rrugës Rambaja - Hajvali në vlerë prej 283 591 eurosh", është thënë në njoftimin e MIT-it. Siç ka njoftuar kjo ministri, ministri Lekaj e ka siguruar kryetarin Ahmeti se mbështetja e dikasterit që ai drejton nuk do të mungojë për kryeqytetin dhe se projektet, pjesë e

këtij memorandumit, janë të planifikuara në aspektin financiar deri në përfundimin e plotë të tyre. Ndërsa kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, duke e falënderuar ministrin Lekaj për mbështetjen e këtyre projekteve me rëndësi për qytetin dhe qytetarët e Komunës së Prishtinës, ka thënë se kjo komunë do të jetë e kujdesshme për realizimin e projekteve të financuara nga MIT-ja dhe se do të respektohen të gjitha parametrat teknike dhe afatet kohore të parapara për këto projekte.





# MTI-ja, OEK-u dhe Dogana, memorandum bashkëpunimi për lehtësimin e tregtisë

Përfaqësuesit e MTI-së, të OEK-ut dhe të Doganës së Kosovës kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi për ta promovuar portalin për tregti: "Udhëzuesi i Tregtisë Ndërkombëtare". Sekretari i përgjithshëm i MTI-së, Burim Rreci, ka thënë se përmes kësaj platforme kompanitë do t'i marrin informacionet e nevojshme për ta promovuar punën e tyre

EPOKA  
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 MARS - Përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), ata të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) dhe të Doganës së Kosovës, kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi për ta promovuar portalin për tregti: "Udhëzuesi i Tregtisë Ndërkombëtare". "Kjo platformë është lansuar në shkurt të këtij viti, përkrahur nga projekti regional i USAID-it për RRER (Rritja Ekonomike Regionale) - Komponenta për lehtësimin e Tregtisë, si vazhdimësi e platformës së krijuar në vitin 2013, në kuadër të Projektit të USAID-it

për Përmirësimin e Mjedisit Afarist (PPMA)", është thënë në njoftimin e MTI-së.

Sipas këtij njoftimi, udhëzuesi për Tregti Ndërkombëtare ka për qëllim t'i ndihmojë eksportuesit dhe importuesit e mallrave dhe shërbimeve në Kosovë për të kryer transaksione ndërkombëtare të tregtisë. "Është një udhëzues i mirë edhe për kompanitë e huaja që konsiderojnë tregtinë me Kosovën dhe ofron informacione me rëndësi për ta", është thënë në këtë njoftim. Duke iu referuar këtij njoftimi, sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Burim Rreci, ka thënë se përmes kësaj platforme kompanitë do të mar-

rin informacionet e nevojshme për ta promovuar punën e tyre. "Bashkëpunimi ynë institucional tregon qartë për gatishmërinë e Kosovës për rritjen e transparencës, veçanërisht në aspektin e tregtisë. Ne në kuadër të këtij projekti kemi identifikuar për herë të parë lejet dhe licencat e nevojshme të lëshuara nga

autoritetet kosovare në fushën e tregtisë të cilat gjenden në këtë portal", ka deklaruar Rreci. Memorandumi i nënshkruar të hënën parasheh bashkëpunimin në përditësimin e të dhënave ekzistuese, plotësimin e saj me të dhëna të reja dhe promovimin e kësaj platforme me qëllim që të rritet besueshmëria e kompanive

në lidhje me informacionin e ofruar në të. "Bashkëpunimi parasheh edhe shkëmbimin e zyrtarëve dhe të ekspertëve me qëllim ngritjen e kapaciteteve institucionale në kuadër të komponentës për lehtësimin e tregtisë", është thënë në njoftimin e MTI-së, e cila drejtohet nga ministri Endrit Shala.

## Haradinaj: Duhet të kthehemi në një komb inovativ në ekonomi

PRISHTINË, 25 MARS (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë në takimim e Këshillit Kombëtar për Inovacion dhe Ndërmarrësi, në të cilin është prezantuar puna e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe është diskutuar për hapat e mëtejshëm për zhvillim në këtë fushë. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka thënë se nuk ka njeri në glob që nuk është i ekspozuar domosdoshmërisht të ecë me ato që ndodhin në jetën e njerëzimit, konkretisht me atë që konsiderohet një revolucion digjital. Në këtë drejtim, ai ka thënë se edhe Kosova është pjesë e kësaj lëvizjeje. "Jemi para një presioni të madh, si kohor, si të kërkesave praktike të mënyrës së jetesës, të bërit ekonomi, të veprimit të vlerës së re, pra një revolucion është duke ndodhur në botë dhe ne nuk bëjmë për-



jashtim. Duhet të bëhemi të përgjegjshëm me këtë dhe ta gjejmë perspektivën tonë", ka thënë Haradinaj.

Ai ka thënë se populli i Kosovës është një prej vendeve që ka shtrirje shumë të gjerë të përdoruesve të internetit, ku mbi 70 për qind e prodhimit ose veprimtarisë në teknologji

informative biznesore është për eksport. "Ne kemi plot sfida sa i përket zhvillimit ekonomik. Arsimi dual është sfidë. Trajnimi, kualifikimi i mëtejshëm për këta trendë globalë të të bërit biznes, po ashtu është sfidë. Dhe, jam i interesuar si Qeveri, duke pasur parasysh faktin se kemi Ministrinë e Inovacionit, kemi

fondin, që t'ju qëndrojmë afër të gjithë atyre që janë ekzistues në të bërit biznes në teknologji ose ekonomi digjitale dhe atyre që janë kandidatë potencialë në të ardhmen", ka thënë Haradinaj. Ndërsa ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka thënë se janë këtu që ta japin kontributin e tyre në fjalën

e dhënë të kryeministrit, i cili këtë vit e ka shpallur si vit ekonomik.

Po ashtu, ai ka thënë se janë pjesë e këtij takimi për ta prezantuar punën që është bërë deri tash nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, në bashkëpunimin që kanë pasur me të gjitha institucionet vendore si dhe me bashkëpunëtorët ndërkombëtarë, siç është fjala për bashkëpunimin e shkëlqyer me GIZ-in gjerman. Kryeministri Haradinaj në këtë takim ka thënë se Kosova duhet të shndërrohet në një komb ekonomik dhe digjital, dhe se përkrahja e rreth 160 bizneseve fillestare dhe investimi në Parkun Inovativ dhe Trajnues janë dy veprime konkrete, të agjendës ekonomike që ka Qeveria dhe në këtë drejtim, do të ofrohet mbështetja e nevojshme për nismat e kësaj natyre.


## Ujësllësi njofton konsumatorët borxhlinj për aksionin e ndërprerjes së ujit

PRISHTINË, 25 MARS (ER) - Kompania Rajonale e Ujësllësit (KRU) "Prishtina" ka njoftuar konsumatorët nga Prishtina, Fushë-Kosova, Lipjani, Podujeva, Obiliqi, Shtimja, Drenasi dhe Graçanica, se aksioni përshkqyjen e ujit ndaj borxhlinjve

është duke vazhduar me intensitet të lartë. Sipas ujësllësit, konsumatorët kanë obligim ligjor t'i paguajnë faturat si dhe borxhin e akumuluar të ujit të shpenzuar dhe nëse nuk reflektojnë brenda muajit, kompania është e detyruar

t'i ndër marrë masat ndëshkuese ligjore, bazuar në ligjet në fuqi. "Ujësllësi i kryeqytetit falënderon të gjithë konsumatorët për pagesa të shërbimeve të ujësllësit dhe fton urgjentisht secilin prej tyre, që të jenë sa më të

rregullt në pagesa, sepse vetëm në këtë mënyrë mund t'u shmangen ndëshkimeve të kompanisë, gjegjësisht ekepeve të shqyqjes dhe procedimit të lëndëve të përbaruesit privatë", është thënë në KRU "Prishtina".





# Presidenti Meta, referencë kushtetuese dhe ekuilibri politik



Prof. Lisen BASHKURTI

Pas deklarës së presidentit Ilir Meta të bërë kohët e fundit lidhur me krizën politike dhe institucionale në Shqipëri dhe qëndrimin e tij lidhur me të u bënë shumë përpjekje nga politikanë, analistë dhe gazetarë të ndryshëm për interpretimin e saj. Mbi të gjitha tërhoqi vëmendjen publikimi i kësaj deklarate në më shumë se 180 media ndërkombëtare, agjenci dhe portale në mbarë botën.

Nga tërësia e interpretimeve dhe komenteve rreth deklarës së presidentit Meta për krizën politike dhe institucionale në Shqipëri bien në sy interpretime dhe komente politikisht të motivuara, patalogjikisht të infektuara, konjunkturalisht të ndikuara, pragmatikisht të abuzuara. Por, jashtë dhe pavarësisht prej këtyre interpretimeve dhe komenteve të cekëta, mund të vërehet se shumica e medimeve që u morën me deklaratën e presidentit Meta arritën në dy konkluzione shumë realiste dhe të rëndësishme për t'u konsideruar seriozisht nga të gjithë faktorët lokalë dhe ndërkombëtarë, që në një

mënyrë apo tjetër merren me Shqipërinë ose janë të interesuar për të.

## 1. Presidenti Meta, referencë kushtetuese

Kriza shqiptare ka hyrë në një fazë të avancuar, komplekse dhe të paqartë në zgjidhjen e saj. Këtë karakter kompleks, kaotik dhe konfuz në adresimin e saj kriza aktuale shqiptare e ka kryesisht për shkak të vakuimit institucional të shkaktuar nga ecuria e reformës në drejtësi, e cila për momentin e ka lënë vendin pa Gjykatë Kushtetuese, ku do të duhej të ballafaqoheshin palët, qëndrimet, vendimet dhe ligjet bazuar në konstitucionalizëm.

Mungesa e Gjykatës Kushtetuese pa pikë dyshimi është shprehje e paaftësisë parashikuese të ideatorëve dhe realizuesve të reformës në drejtësi, të cilët e kanë lënë vendin të ekspozuar pa konstitucionalizëm në një prej periudhave më të rëndësishme të ndërtimit dhe të funksionimit të shtetit ligjor. Ky vakum shumë serioz ka bllokuar procese të brendshme, procese të marrëdhëniesve fqinjësore, të bashkëpunimit rajonal dhe të integritimit evropian.

Në këto kushte shumë të rënda është vetëm presidenti i Republikës, z. Meta, që po bën përpjekje shumë serioze për t'u shndërruar në referencë kushtetuese për vendin. Në praktikën afro 30-vjeçare që kemi

ndeshur mbas viteve '90 është e para herë që një president i Shqipërisë ka bërë kaq përpjekje për të vendosur çdo deklaram, çdo qëndrim, çdo veprim, çdo akt ligjor në suazën e interpretimit kushtetues.

Natyrisht që ky veprim i admirueshëm dhe i vlerësueshëm i presidentit Meta është diktuar nga vakuumi i Gjykatës Kushtetuese por, para së gjithash, nga përgjegjësia e lartë institucionale e vetë Presidentit, që edhe në mënyrë të sforcuar ka bërë gjithë përpjekjet për arsyetim kushtetues dhe vetëm kushtetues të deklaramëve, qëndrimeve, veprimeve dhe akteve ligjore të ndërmarra prej tij. Me këtë përgjegjësi presidenti Meta ka amortizuar në një masë të konsiderueshme mungesën e Gjykatës Kushtetuese, natyrisht aq sa e lejon statusi i tij kushtetues dhe kuadri kohor i veprimeve të tij.

## 2. Presidenti Meta, pikë ekuilibri politik

Kriza aktuale e Shqipërisë nuk ka nisur sot dhe as në mënyrë të papritur. Simptomat e saj janë dhënë prej disa kohësh. Duke mos u konsideruar seriozisht dhe duke mos u adresuar në kohën dhe në mënyrën e duhur, këto simptoma krize kanë ardhur duke u zgjeruar si rathë koncentrikë, duke përfshirë thuajse të gjitha fushat e jetës së vendit: politike, institucionale,

ekonomike, sociale, psikologjike dhe shpirtërore. Madje kohët e fundit kriza e Shqipërisë, deri pak kohë më parë kryesisht e brendshme, po shndërrohet edhe në krizë marrëdhëniesve fqinjësore, rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare.

Në thelbin e vet kriza aktuale e Shqipërisë është krizë politike, shpaloset qartë si krizë midis mazhorancës dhe opozitës shqiptare, për konsekuencë ka marrë dimensionet e një krize të demokracisë, të tipareve, vlerave dhe institucioneve të saj. Qendra e krizës gjeneroi nga parlamenti shqiptar. Kulmoi në parlamentin shqiptar. Dha goditjen më të madhe në parlamentin shqiptar. Mirëpo duke qenë se sistemi politik shqiptar është republikë parlamentare, demokratike, pluraliste, kriza parlamentare gjeneron në të gjitha fushat dhe në të gjitha dimensionet e saj. Por, kyçi i krizës është politika.

Në kushtet e krizës nga më të përkeqësuarat politike në vend po thellohet polarizimi politik, po përkeqësohen marrëdhëniet midis qeverisjes qendrore dhe vendore, po rëndohet skajshëm situata ekonomike dhe pasojat sociale dhe po tronditen rëndë marrëdhëniet e Shqipërisë me fqinjët, rajonin, BE-në dhe më gjerë.

Në këtë mjedis politik traumatik, të polarizuar dhe konfrontues, është vetëm institucioni i presidentit të Republikës, z. Meta, që po mban qëndrime, po bën

deklarime dhe po përpjeket të ndërmarrë veprime për t'i ruajtur ekuilibrat politike në vend. Presidenti Meta në mënyrë konstante dhe të përsëritur ka qenë këshillues, kritik dhe qortues për situatën e përkeqësuar, duke vënë gishtin te shkaqet dhe te shkaktarët. Presidenti Meta ka ruajtur distancimin ndaj palëve, ka evituar përshfirjen e drejtpërdrejtë në polarizimin politik, ka kritikuar qëndrimet e veprimet arrogante të mazhorancës dhe ekstreme të opozitës, ka apeluar për dialog politik midis palëve, ka bërë thirrje që palët të bashkohen në një pakt kombëtar për hir të hapjes së negociatave për anëtarësim të Shqipërisë në BE. Pa pikë dyshimi presidenti Meta gjatë tërësive të krizës ka bërë përpjekje për të ruajtur ekuilibrin politik në vend. Ndonëse jo gjithnjë i mirëkuptuar, ndonëse në jo pak raste edhe i kritikuar nga njëra apo tjetra palë, presidenti Meta ka vijuar t'i ruaj parimet kushtetuese, neutralitetin politik dhe qetësinë në sjelljen e tij. Ndonëse është e vështirë të thuhet saktësisht se si do të duhej të ndikonte presidenti Meta mbi krizën, ajo që mund të thuhet deri tani pa pikë dyshimi është fakti se pa rolin e tij rigorozisht kushtetues dhe paaftësinë e tij për ta ruajtur qetësinë dhe ekuilibrin politik kriza e vendit do të ishte shndërruar në një kolaps të plotë kushtetues dhe ballafaqim shumë më të rëndë politik dhe social të brendshëm dhe ndërkombëtar.

## Veseli takon familjarët e heronjve Idriz Seferi, Shaban Polluzha, Marie Sllaku dhe Ismail Thaqi

PRISHTINË, 25 MARS (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të hënën në takim familjarët e heronjve të cilët janë vendosur në pulat postare të Kosovës: Idriz Seferi, Shaban Polluzha, Marie Sllaku dhe Ismail (Imer) Thaqi.

Në këtë takim kryeparlamentari Veseli ka thënë se për Kosovën është nder që figura heronjsh e veprimtarësh si Idriz Seferi, Shaban Polluzha, Marie Sllaku, Ismail Thaqi e shumë të tjerë, të jenë imazh përfaqësues i saj. Ai ka theksuar se u takon të gjithëve të nderojnë figurat e shquara kombëtare, të cilët me veprën e tyre lanë gjurmë të pashlyeshme në përpjekjet e popullit tonë për liri, duke u bërë frymëzim për gjeneratat dhe brezat pasues, të cilët vazhduan dhe çuan më tej kauzën e popullit tonë.

Familjarët e veprimtarëve të njohur të çështjes kombëtare e kanë falënderuar kryetarin Veseli dhe institucionet e Kosovës, të cilat, sipas tyre, po lartësojnë figurat e shquara kombëtare, duke i bërë kështu nder të kaluarës së lavdishme dhe të ardhmes së kombit tonë.





# Pavarësia e Kosovës dhe veprimtarët ilegalë të lëvizjes kombëtare



**Prof. dr. Sabile  
KEÇMEZI-BASHA**

Çështja e Kosovës, e cila gjatë regjimit komunist paraqiste një problem "të zgjidhur" nën hijen e propagandës jugosllave, se çështjet nacionale ishin zgjidhur përfundimisht, në fillim të viteve '90 nisi t'i kalojë kufijtë e ish-Jugosllavisë dhe ta marrë dimensionin e një problemi që kërkonte përfshirjen e kancelarive botërore.

Interesimi i shprehur nga bashkësia ndërkombëtare për çështjen e pazgjidhur shqiptare mund të thuhet se kishte ndodhur menjëherë pas demonstratave studentore të vitit 1981 dhe dukshëm vjen në shprehje pas vitit 1989. Ky interesim i shtuar kishte ndodhur për shumë arsye: 1. Fundi i shembjes së sistemit komunist më 1989-1990, që shënon fillimin e një epoke të re në politikën botërore, e që reflektoi pozitivisht në zhvillimet politike në hapësirën shqiptare, në këtë kontekst edhe në Kosovë, e cila, për shkak të politikës së agresionit serb, arriti të bëhet pjesë e këtij procesi politik pluralist vetëm pas nxjerrjes de facto të Kosovës jashtë sovranitetit të Beogradit, më 10 qershor 1999, si dhe pas vendosjes së administratës ndërkombëtare të OKB-së dhe pranisë ushtarake të NATO-s në Kosovë; nën 2. Fundi i Luftës së Ftohtë, i viteve 1989-1990, që shënon fillimin e një epoke të re në politikën evropiane, që pasohet me formimin e shteteve të reja kombëtare në Ballkan dhe në Evropën Lindore e Juglindore; dhe nën 3. Riorganizimi i Lëvizjes Ilegale Kombëtare Shqiptare në rezistencën aktive ushtarake, UÇK-së.

Natyrisht se të gjitha këto ngjarje patën jehonë pozitive edhe në Kosovë dhe të shqiptarët, që për një të drejtë të natyrshme historike ishin angazhuar që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e këndeje. Por, kthesën më të madhe Lëvizja Ilegale Kombëtare Shqiptare e pëson më 1981 dhe e përfundon në fund shekull 20, në kohën kur zë fill formimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe e tërë lufta kurorëzohet me çlirimin e saj. Kjo edhe është periudha më e rëndësishme; është përmblyllje kulminante e një lëvizjeje të gjatë ilegale në Kosovë dhe në trojet e tjera shqiptare të ish-Jugosllavisë.

Duhet theksuar se edhe brenda organizatave politike të kohës kishte dallime rreth artikullimit programor, se cila ishte platforma më e mundshme dhe më e përsh-

tatshme që duhej të përdorej për rrethanat e kohës, për të ardhur deri te një strategji e përbashkët e veprimit. Organizatat ilegale që vepruan në këtë periudhë, që të gjitha mund të thuhet se punonin në bazë të programeve politike dhe kishin statutet e tyre. Programet, platformat dhe synimet e tyre ishin thjesht të karakterit kombëtar dhe qëllimi suprem i të gjitha atyre ishte mëvetësia e Kosovës dhe bashkimi me Shqipërinë. Dallimet konsistonin në atë se si duhej t'i qaseshin zgjidhjes së çështjes kombëtare, ngaqë veprimtarët e ilegales asnjëherë në qëndrimet e tyre nuk ishin dogmat, por varësisht prej rrethanave kombëtare e ndërkombëtare, krijonin edhe qëndrimet e tyre. Këtë të dhënë më së miri e dëshmon evoluimi i qëndrimeve rreth zgjidhjes së statusit të Kosovës në situata të caktuara, që do t'i paraqes, të përmbledhura në tre opsione si: 1. Bashkimi i të gjitha tokave shqiptare me Shqipërinë; 2. Bashkimi i të gjitha trojeve shqiptare në një republikë brenda Jugosllavisë dhe nën 3. Republika e Kosovës.

Që të tri këto opsione të shtruara nga veprimtarët e ilegales të Lëvizjes Kombëtare, në periudha të ndryshme kohore, kishin edhe bartësit e vet ideorë. Opsionin e parë për bashkimin e trojeve shqiptare me Shqipërinë në programin e saj e kishte paraparë LNDSH-ja, LRBSH-ja, OMLK-ja dhe Lëvizja Nacionale për Çlirimin e Kosovës dhe Viseve të Tjera Shqiptare në Jugosllavi. Opsionin e dytë e kishte paraparë organizata "Partia Marksiste-Leniniste Shqiptare në Jugosllavi", e cila në programin e vet parashihte bashkimin e të gjitha trojeve ku shtriheshin shqiptarët në një republikë në kuadër të RSFJ-së. Megjithatë, veprimtaria dhe mendimi politik i shqiptarëve në Kosovë nuk u zhvillua lirshëm si pasojë e statusit politik e juridik të popullit shqiptar në Jugosllavi; si pasojë e pengesave që vinin nga represioni i madh nga Republika e Serbisë dhe Lidhja Komuniste e Jugosllavisë, e cila nuk pranonte alternativë tjetër të zhvillimit e të mendimit politik; si pasojë e gjendjes së vështirë ekonomike, arsimore dhe kulturore dhe si pasojë e faktit se angazhimi politik për pavarësinë e Kosovës zhvillohej nga veprimtarët që vepronin në ilegalitet.

Opsioni i tretë, apo zanafilla e idesë për Republikën e Kosovës, ishte shpalosur fillimisht me demonstratat e vitit 1968, por si më e sforcuar u paraqit në formë të plotë, në periudhën e demonstratave të vitit 1981 e 1989. Kjo kërkesë ishte shtuar madje edhe në diskutimet publike që u bënë menjëherë pas rënies së Rankoviçit. Këto biseda, sipas dokumenteve, dëshmojnë se janë zhvilluar edhe mes të udhëhe-

qësve të Kosovës me udhëheqësit më të lartë të Jugosllavisë.

Kosova Republikë, pas shumë bisedimeve në mes të veprimtarëve të Lëvizjes Kombëtare ilegale, ishte kërkesë e të gjitha grupimeve ilegale pas vitit 1968, 1981, 1989, që më vonë do të bëhet kërkesë e gjithë popullit shqiptar në Kosovë dhe në viset e tjera jugosllave të banuara me shqiptarë. Kërkesa për Republikë, për kohën ishte më e përshtatshme ngase prapa kësaj qëndronte kërkesa për bashkim kombëtar me shtetin amë-Shqipërinë. Prandaj, këtu edhe qëndron çelësi i zgjidhjes së problemit të quajtur Kosovë. Latinët e vjetër thonë: "Nuk mund të qetësohet një popull në qoftë se nuk dëgjohej zëri i tij, "Vokspopuli-voksidei". Andaj, ngjarjet në vijim hapën një kapitull të re brenda kombit shqiptar, hapën një proces të ri politik edhe për shtetin shqiptar.

Me ngjarjet e viteve 1989 e këndeje që pasuan në ish-Jugosllavi, me një mënyrë filloi edhe dekompozimi i federatës jugosllave, ndërsa shqiptarët si andej e këndeje kufirit iu rikthyen qytetërimin të vet, pra bashkësisë së qytetërimin evropian.

Mirëpo, pas ndryshimeve të shumta politike që pasuan në mes viteve '89-'99 të shekullit të kaluar, veprimtarët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare që vepronin në ilegalitet, por edhe ata që vepronin në parti të ndryshme politike legale që u formuan gjatë kësaj periudhe, duke e par dhe hetuar ndikimin e faktorit të brendshëm dhe të atij ndërkombëtarë, në qëndrimet e veta filluan të bënin korrigjime në qasje dhe në organizim.

Programet politike e kombëtare dhe mjetet e format e luftës me të cilat parashihej të arriheshin qëllimet e saja, në esencë kishin mbetur të pandryshueshme gjatë gjithë historisë së lëvizjes kombëtare. Por, forma më e lartë e rezistencës, lufta e armatosur, ndonëse ishte pjesë e programeve, por edhe e praktikës historike të lëvizjes kombëtare, arriti të zbatohet në tërë kuptimin dhe gjerësinë e saj, vetëm në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, atëherë kur u krijuan kushtet e brendshme dhe të jashtme për të, kur u poqën faktorët subjektivë dhe objektivë të lëvizjes. Brezat e mëparshëm të lëvizjes ilegale, nuk mund ta bënin këtë, në Jugosllavinë stabile e me prestigj ndërkombëtar dhe në rrethanat e luftës së ftohtë, që karakterizonte gjithë periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore, deri nga fundi i viteve të gjashtëdhjeta, por as gjatë të ashtuquajturës detantë, që e pasoi të parën. Megjithatë, lufta çlirimtare përgatitej dhe zhvillohej shkallë-shkallë përballë valëve të egra të dhunës që ushtronte pushtuesi.

Ky besim dhe ky angazhim i pa kursyer i ilegales dhe besimi i madh në popullin e vet, ndikoi që

të formohej edhe UÇK-ja, ngase çdo organizatë ilegale në ish Jugosllavi, në programet e tyre, përveç zgjidhjes paqësore të çështjes shqiptare ato parashihnin edhe zgjidhjen me luftë, andaj dalja në skenë e UÇK-së nuk ishte e rastësishme dhe se ishte krahu më i natyrshëm i Lëvizjes Kombëtare në Kosovë që nga viti 1945. Lufta e Kosovës nën udhëheqjen e UÇK-së, dhe ndihma e madhe nga faktori ndërkombëtar që sollën lirin që ne sot e gëzojmë, dëshmon dhe provon se ishte vepra më madhore e të gjithë atdhetarëve që u angazhuan për Pavarësinë e saj duke mos kursyer as jetën e tyre. Ky organizim i ri dhe kjo qasje e re politike e ushtarake me kohë kishte kaluar barrierat ideologjike dhe nuk e shihte më veten pre të asnjë ideologjie. Bile, për hir të interesave më madhore kombëtare, gati të gjithë ish të burgosurit politikë në vitet e '89-'99, me daljen nga burgu kishin aderuar në radhët e LDK-së, e parti të tjera të formuara legalisht, vetëm e vetëm që të bënin unitetin kombëtar edhe më të fuqishëm, por ka ndodhur edhe kjo se më vonë kur po ata iu bashkonin radhëve të UÇK-së, paraprakisht deklarimin se nuk i takonin asnjë partie, se për ta ekzistonte vetëm UÇK-ja si faktor politik e ushtarak i Kosovës. Në këtë luftë dhe në këtë angazhim të veprimtarëve ilegal dhe të shqiptarëve në përgjithësi i kishte ndihmuar dhe mbajtur gjakimi shekullor i shumë gjeneratave që ishin flijuar për pavarësinë e tokave shqiptare.

Vetëm kur të studiohet mirë e shkencërisht kjo periudhë do të kuptohet më mirë e më drejt e tërë situata politike e ushtarake në të cilën kaloi Kosova. Edhe pse kjo situatë e rëndë me kalimin e viteve do të davaritej, në Kosovë do të ndihej rëndë pesha e represionit të egër serb, por edhe më tej tek populli shqiptarë do të rritej besimi te ShBA-të e Evropa, si kod më i pathyeshëm për lirinë dhe sigurinë globale. Bashkësia ndërkombëtare shfaqet si forcë rrezatuese për zgjidhjen e problemit të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, ngase ata (shqiptarët) pa dashjen e tyre kishin ngelur larg saj. Angazhimin e madh që bënë forcat kombëtare për tu

kthyer aty, në Evropë nuk ishte i lehtë, ashtu siç ishte menduar në fillim të viteve '90. Ajo madje, shpesh acaroi edhe kancelaritë euro-perëndimore.

Është karakteristik e kësaj etape se në këtë kohë organizimi i lëvizjes ilegale kombëtare kishte pësuar ndryshime të mëdha. Grupe të vogla që vepronin ilegalisht pas demonstratave studentore të '81-s filluan të bashkohen dhe të formonin organizata më të mëdha po që kryesisht vepronin në interes të zhvillimit të Kosovës dhe të krijimit të kushteve të reja, qoftë në ngritjen e pozitës kushtetuese të saj, qoftë për përmbushjen e idealit të ilegales-bashkim kombëtar. Duhet përmendur me këtë rast grupet siç ishin: Fronti Popullor për Republikën e Kosovës, Lëvizja studentore e vitit '81, Grupi i intelektualëve të Kosovës, Fronti i Çlirimit Kombëtar, Partia Komuniste Marksiste-Leniniste Shqiptare në Jugosllavi etj.

Vitet 1991-1999, janë vitet më kulminante të Lëvizjes politiko-ushtarake në Kosovë, dhe në historinë më të re të kombit tonë, me të drejtë duhet të cilësohet si periudha e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së). Në fillim të viteve të '90-ta përveç partive legale politike, si LDK, PPK, PSHDK, PLK etj, vepronin edhe disa organizata politike - Kombëtare ilegale, si: "Fronti Kombëtar" (1990-1991), "Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës" nga marsi 1993...dhe Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës dhe disa më të vogla.

Rëndësia e kësaj politike dhe e kësaj lufte më vonë kishte shënuar ngritje graduale pozitive, mund të thuhet që nga Rezoluta e Parlamentit Evropian (1989) e deri te përkrahja e planit gjithëpërfshirës të Marti Ahtisarit. Zgjidhja e çështjes së Kosovës, e cila ishte edhe sfida e fundit e madhe që kishte mbetur në Ballkan pas shpërbërjes së Jugosllavisë, respektivisht bërja e pavarësisë së Kosovës mbi bazën e Planit të Ahtisarit, i cili përbën një zgjidhje kompromisi, është një sprovë përfundimtare për politikën e jashtme të Bashkimit Evropian, të ShBA-ve dhe e Bashkësisë Ndërkombëtare në përgjithësi. (Fusnotat i ka hequr redaksia)





**E jashtëzakonshme**

## Kriminelët mbushin minjtë e ngordhur me drogë e telefona

Kriminelët kanë mbushur minjtë të ngordhur me drogë dhe telefona celularë për t'i kontrabanduar brenda burgjeve. Minjtë e ngordhur u përdorën për të fshehur kanabis, duhan, celularë, karikues, karta



telefoni dhe letra cigareshe në HMP Guys Marsh në Dorset.

## BARSOLETA E DITËS



**Gardiani dhe shefi:**

- Shefi: Kujdes shumë me këta të burgosurit, se janë tepër problematikë.
- Gardiani: Shef, sa të jem këtu s'do të ketë problematikë, se shkelma jashtë i qes.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC


Në ora 16:00

## "THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



**FOTO E DITES**



Dielli në malin e Mont Blancit në Zvicër. Fotografia: Valentin Flauraud. /EPA/

Në ora 17:30  
**"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D**

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston



Në ora 19:30  
**"MORTAL ENGINES" 3D,**

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00  
**"HUNTER KILLER",**

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

**E rrallë**

## Qeni hero shpëton familjen nga zjarri

Nuk është sekret që qentë janë miqtë e njerëzve. Dhe një burrë nga ShBA-ja ka provuar vlerën e kësaj miqësie. Në një postim në "Twitter" ai ka treguar se si qeni i tij hero e shpëtoi së bashku me familjen nga një zjarr masiv. Ulysses S. Cocksman shkoi të flinte gjumë së bashku me fëmijët dhe bashkëshorten. Por, rreth mesnatës, Hank filloi të lehte me zë të lartë. I shqetësuar se mos fëmijët zgjoheshin nga gjumi, ai u ngrre nga gjumi për të parë se çfarë kishte qeni i tij dhe



kur e pa nuk mund t'u besonte syve. I gjithë kopshti i tij ishte përfshirë nga flakët. Ai menjëherë zgjoi familjen dhe i nxori të gjithë jashtë, së bashku me dy qentë për t'i shpëtuar.

 <p><b>DASHI</b> Sot keni probleme përqendrimi sepse doni të zgjidhni disa punë përnjëherësh. Në fund të ditës do të përfundoni duke shkatërruar gjithçka.</p>	 <p><b>DEMI</b> Kjo nuk është dita juaj dhe jeni gjithë kohës nën stres. Do të mundoheni t'i menaxhoni emocionet, por shumë e vështirë të ndodhë.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Jeni të rrethuar nga njerëz pozitivë dhe që mendojnë vetëm për të mirën tuaj. Kjo gjë ju shtyn të veproni më të sigurt.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Ditën e sotme keni nevojë për siguri. Këtë gjë do ta kërkonti si nga kolegët e punës, po ashtu edhe nga partneri.</p>	 <p><b>LUANI</b> Një ndjesi plogështie do t'ju shoqërojë sot gjatë gjithë ditës. Është mirë të bëni një kontroll për të parë që çdo gjë shkon mirë me fizikun tuaj.</p>	 <p><b>VIRGJËRËSHA</b> Edhe pse ju duket sikur të tjerët nuk do t'ju vijnë në ndihmë sot për një problem të caktuar, gaboheni. Miqtë tuaj do të jenë aty për ju.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Një debat i ndezur me partnerin që në orët e para të mëngjesit do t'i ketë pasojat e tij përgjatë gjithë ditës së sotme.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Do t'ju thonë një të vërtetë të hidhur sot që do të parapëlqenit të mos e dinit. Respekti për një person do t'ju humbë përgjithmonë.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Keni nevojë për qetësi këto kohë për të menduar me mirë dhe me kthjellët ndryshimet e mëdha që doni të realizoni.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Merrni kohë në dispozicion për t'iu përkushtuar interesave tuaja dhe familjes. Do të shikoni që ju mungonin këto çaste kënaqësie.</p>	 <p><b>UJORI</b> Sot mbase do t'ju tërheqë një ndjenjë që do të tregojë në të ardhmen se është shumë më e fortë sesa që e mendoni.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Edhe pse ju kanë dalë disa probleme të vogla financiare, kohët e fundit do të arrini të zgjidhni gjithçka. E rëndësishme është t'i ndani prioritetet.</p>



## Çka po ndodh me të bijën e Michael Jacksonit pasi tentoi të vetëvritej?



**P**aris Jacksoni është në një gjendje shumë më të mirë mendore që nga tentimi i saj për t'u vetëvrasë. Ajo është duke kaluar kohë me miqtë, familjen dhe duke marrë këshilla nga njerëz që vërtet interesohen për të. "TMZ" ka raportuar javën që shkoi se Jacksoni në një spital të Los Angelesit deshi të bënte vetëvrasje


duke prerë venat. Të afërmit e Parisit e kishin shtyrë 20-vjeçaren të shkonte në rehabilitim por, pa sukses, kështu duke e lënë mirëqenien e saj në duart e saj. Burimet familjare tregojnë për "TMZ" se Paris po përpiqet ta përmirësojë shëndetin mendor dhe fizik dhe se është e hapur për t'i dëgjuar njerëzit tek të cilët ka besim.

## Gigi Hadidi, pa grim në palestër



**K**ohët e fundit ajo u kthye përsëri në Nju Jork City pas shfaqjes së saj në Javën e Modës së Parisit, Londrës dhe Milanos. Gigi Hadid

është parë afër palestrës. Bukuroshja 23-vjeçare ishte e veshur me rroba sportive nga marka me të cilën ka bashkëpunim, "Reebok".



## Bebe Rexha duket e mrekullueshme

**K**ëngëtarja nga Shqipëria, Bebe Rexha, ka marrë pjesë në ceremoninë e "Kids' Choice Awards së Nickelodeon". Bebe Rexha ka

pasur të veshur një bluzë ngjyrë të gjelbër e cila i rrinte për trup. Bebe Rexha me këtë veshje dukej seksi dhe e mrekullueshme.

## Britney dëshiron të martohet, por nuk e lë babai



**S**ipas "Radar Online", këngëtarja e popit është gati të martohet me të dashurin e saj Sam Asghari. Jo vetëm që Britney dëshiron të martohet, por ajo dëshiron edhe të ketë edhe një fëmijë. Ajo është në lidhje të gjatë me trajnerin

25-vjeçar, shumë më i ri se ajo. Gjithsesi, Jaime Spears, babai i sëmurë i Britneyt, ka ide të tjera. "Britney dëshiron të martohet me Sam dhe të ketë një fëmijë tjetër, por babai i saj thotë jo!", tregon një burim për "Radar".



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE  
**"BUJQËSIA"**  
TEL: 045 82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ZVICRA - DANIMARKA

GG3+

MALTA - SPANJA

DP2

BOSNJA - GREQIA

1

# Kosova dominon ndaj Bullgarisë, mungon vetëm fitorja

"Dardanët" kanë shkëlqyer edhe një herë tjetër në stadiumin "Fadil Vokrri", por nuk kishin fat të merrnin pikët e plota ndaj Bullgarisë, ani pse dominimi ishte gjatë gjithë ndeshjes. Përveç një pikë të fituar nga kjo përballje, Kosova tash ka dymbëdhjetë ndeshje pa humbje dhe në vazhdimësi po dëshmon se ka potencial të përballet edhe me kombëtarët e mëdha

**EPOKA E VETON ZYMBERI**

**PRISHTINË, 25 MARS** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka dominuar ndeshjen kualifikuese për Kampionatin Evropian "Euro 2016" ndaj Bullgarisë, por është dashur të pajtohet në fund me barazim (1-1). Dominimi i Kosovës ishte si nga rastet për shënim të ashtu edhe posedimi i topit, por bullgarët ishin me fat që nxirren një pikë nga përballja e zhvilluar ndaj "Dardanëve" në stadiumin "Fadil Vokrri" për faktin se shumë raste të Kosovës përfunduan pa sukses. "Ishte ndeshje e vështirë. Bullgaria ka mbrojtje të mira. Në pjesën e parë bëmë gabime të panevojshme, por në pjesën e dytë patëm katër raste për gol. Efikasiteti është më e rëndësishmja. Pjesa e dytë ishte më e mirë. Ata u mbrojtën edhe ndaj Malit të Zi. Ne patëm lojë të mirë, por rezultatin jo. Mund të jemi të zhgënjyer, por kemi skuadër të re e Bullgaria ka përvojë. Duhet të mësojmë po ashtu. Në fund dy pikë më shumë do të ishte më mirë, por duhet të jetojmë me këtë dhe të tregojmë se jemi kandidat i fortë. Qëndroj pozitiv për performancën, jo për rezultatin", ka thënë Bernard Challandes, përzgjedhës i Kosovës. Në minutën e tetë Vojvoda bëri një dalje të mirë, por në fund nuk arriti të pason mirë deri të Muriqi dhe mbrojtja vendase intervenon duke e larguar rrezikun. Një minutë më vonë "Dardanët" rrezikuan seriozisht, Milot Rashica e kaloi portierin mysafirë, por topin e goditur nuk e lejoi Nedyalkov



## STADIUMI "FADIL VOKRRI"

**Shikues:** 13500  
**Shënues:** Vasil Bozhikov (39'), Arber Zeneli (61')  
**Gjyqtarë:** Gediminas Mazeika  
**Kartone të verdhë:** Vojvoda, Kryeziu, Halimi (Kosova), Nedyalkov, I.Popov, S.Popov, Antov (Bullgaria)  
**Kosova:** Muriq, Vojvoda, Rrahmani, Aliti, Kololli (Paqarada), Kryeziu, Shala (Zhegrova), Rashica, Celina (Halimi), Zeneli, Muriqi.  
**Bullgaria:** Mihaylov, S.Popov, N.Budorov, V.Bozhikov, A.Nedyalkov, G.Kostadinov (Valentin Antov), T.Nedelev, K.Malinov (Minchev), Slavchev, I.Popov, S.Delev (Zanev).

të përfundon në rjetë. Edhe në minutat në vazhdim dominimi ishte në anën e Kosovës që shpesh dilte në sulm nëpërmjet aksioneve nga krahët, kurse në minutën e 35-të,

Bersant Celina rrezikoi seriozisht duke goditur fuqishëm, por portieri Mihaylov intervenoi për mrekulli. Në minutën e 39-të, pas një rivënie nga këndi bullgarët shënojnë nëpërmjet Vasil Bozhikov dhe ky ishte i vetmi rast që kishin mysafirët në këtë ndeshje. Dy minuta para fundit Milot Rashica gjuan fuqishëm, por edhe një herë tjetër portieri Mihaylov ia mohoi golin Kosovës. Edhe pjesa e dytë ishte më e mirë nga vendasit të cilët patën rast të barazojnë në minutën e 55-të, por gjuajtja e Vedat Muriqit përfundoi në shtyllën pingule, kurse nga topi i rikthyer nuk përfitoi Vojvoda. Gjashtë minuta më pas, Zeneli bëri një depërtim të bukur dhe nga një largësi prej njëzetë metra arriti të shënon për 1-1. Ky gol ngriti në këmbë të pranishmit e shumtë në stadiumin "Fadil Vokrri" të cilët kërkon edhe golin e dytë dhe të fitores, i cili edhe përkundër rasteve të Rashicës dhe Zenelit nuk u arrite dhe Bullgaria më plotë fat mori një pikë nga kjo ndeshje.

## Shqipëria mposhti Andorrën

Kombëtarja e Shqipërisë rigjeti golat dhe pikët, të parat në eliminatoret e Evropianit 2020, por mjaft domethënëse për shpresat e kuqezinjve për të shkuar në finalen e turneut. Ekipi i drejtuar nga trajneri Ervin Bulku u imponua 3-0 në një ndeshje me thuajse një drejtim. Në minutën e 21-të erdhi goli që zhblokoi sfidën nga një gabim i portierit Gomes dhe finalizimi i Armando Sadikut me portën e boshatisur. Edhe në fraksionin e dytë Shqipëria ruajti epërsinë në lojë, por pavarësisht volumit të rasteve, goli i dytë erdhi vetëm në minutën e 88 me Bekim Balajn. Në sekondat e fundit të ndeshjes për rezultatin 0-3 u përkujdes Amir Abrashi, i cili realizoi më kokë.

## SHKURT

### U17-shtat mposhten nga Ukraina

Përfaqësuesja e U17 e Kosovës në futboll e ka nisur me humbje rrethin elitë për kualifikim në Kampionatin Evropian. Të përzgjedhurit e Besnik Kollarit pësuan humbje 2-0 nga Ukraina, në ndeshjen që u zhvillua në Zvicër. Në grup me Kosovën janë edhe Spanja dhe Greqia. Ndeshjen e radhës Kosova e luan të enjten (28 mars) kundër Spanjës, ndërsa të dielën (31 mars) do të përballet me Greqinë.

### Futbollisti zviceran pa vdekjen me sy: Nuk më kujtohet asgjë

Mbrojtësi i Zvicrës, Fabian Schar, përjetoi një çast të frikshëm në përballjen me Gjeorgjinë. Pas një përplasje me një kundërshtar, ai ka rënë në tokë pa ndjenja, raporton "albinfo.ch". Futbollisti gjeorgjian Jano Ananidze ka bërë një intervenim prej një heroi, duke e shpëtuar futbollistin zviceran, derisa erdhi edhe ndihma e stafit mjekësor. "Duket e tmerrshme, nuk mund të kujtoj asgjë. Isha pa ndjenja për disa sekonda. Kam disa dhimbje si në qafë, megjithatë ia vlejti", ka thënë Schar për gazetën zvicerane "Blick".

### Mourinho: Tani fillon karriera për Zidanen

Jose Mourinho që prej shkarkimit të tij nga Manchester Unitedu i ka bërë më të shpeshta daljet e tij në media. Trajneri portugez në deklaratat e tij lëshon shumë thumba në varësi të personit që është duke komentuar. Këtë herë objektiv i tij ishte Zinedine Zidane. Në një intervistë për "Canal Plus", trajneri portugez ka komentuar karrierën e francezit dhe zgjedhjet e tij të deritanishme. "Mendoj se është herët të flasim për karrierën e tij, edhe pse në një kohë të shkurtër fitoi tri Liga të Kampionëve radhazi. Për mua, tani fillon karriera e tij e vërtetë, pasi duhet të marrë vendime për ta ndërtuar ekipin nga e para. Të blejë dhe të shesë lojtarë. Duhet të stërvitet dhe t'i japë një filozofi skuadrës", ka thënë Mourinho.

### Ademi priti ish-futbollistin e Shqipërisë, Fatmir Vata

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, të hënën ka pritur në takim ish-futbollistin e Kombëtares së Shqipërisë, Fatmir Vata, i cili shoqërohej nga Bekim Brestovci, kryetar i Unionit të Bizneseve në Gjermani dhe Fekmi Kongjeli, përfaqësues i FFK-së në Gjermani, e ku të pranishëm ishin edhe anëtarët e KE të FFK-së, Luan Vokshi, Flamur Bunjaku dhe sekretari i përgjithshëm Eroll Salihu. Kryetari i FFK-së, Ademi, fillimisht e njoftoi legjendën e kombëtares kuqezi për punën që po e bën FFK-ja në përparimin e futbollit në Kosovë qoftë në nivel të ekipeve përfaqësuese, qoftë në nivel të ligave, derisa e ka falënderuar atë, së bashku me vëllezërit Shoshi e Kongjeli, për mbështetjen që i ka dhënë futbollit të Kosovës para anëtarësimit në UEFA e FIFA. Ndërkaq, ish-futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, Fatmir Vata, e ka falënderuar presidentin Ademi për mikpritjen e ngrohtë dhe është shprehur krenar me punën dhe sukseset që po i arrin FFK-ja në arenën ndërkombëtare.

GRUPI A	
Kosova - Bullgaria	1-1
Mali i Zi - Anglia	1-5
GRUPI B	
Portugalia - Serbia	1-1
Luksemburgu - Ukrainë	1-2
GRUPI H	
Turqia - Moldavia	4-0
Andorra - Shqipëria	0-3
Franca - Islanda	4-0



## Zidane fillon "operacionin" Mbappe

MADRID, 25 MARS - Kylian Mbappe është në krye të listës së dëshirave të Zinedine Zidane, i cili do të përpiqet ta rindërtojë skuadrën e Real Madridit këtë verë, pasi u kthye në postin e trajnerit. Që

prej se u kthye në "Santiago Bernabeu" në fillim të këtij muaji, Zidane ka synuar ta rindërtojë skuadrën për sezonin e ardhshëm, me Kylian Mbappen dhe Sadio Manen si prioritet. Sipas

revistës franceze "France Football", Real Madridi do ta transferojë të riun francez për një shumë të majme parash. Revista franceze e bëri këtë pohim në një shkrim në ballinën e saj, e ilustruar me

fotografitë e Zidanes dhe Mbappes me titullin: "Operacioni Mbappe". "France Football" po ashtu lë të kuptohet se Realit mund t'i kushtojë Mbappe 280 milionë euro.



## Nëna e yllit e Moise Kean: Na nxori nga varfëria, lindja e tij ishte një mrekulli



TORINO, 25 MARS - Moise Kean është lojtari i momentit në Itali, pasi shënoi dy gola njëri pas tjetrit. Të parin me Juventusin, kundër Udineses, të dytin në debutimin si startues me kombëtaren axurre, kundër Finlandës. Tani, për të na treguar talentin e ri të futbollit italian, ka folur nëna e tij, Isabelle, e cila është intervistuar nga "Tuttosport". Ajo zbulon edhe një detaj për lindjen e Kean. "Giovanni lindi në vitin 1993 dhe Moise në vitin 2000. A e dini pse ne e quajmë atë të voglin e shtëpisë? Sepse lindja e tij ishte një mrekulli. Mjekët më thanë se nuk mund të kisha më fëmijë, unë bërtita dhe u luta. Natën që

ëndërrova për Moise, ai 'kishte ardhur' për të më ndihmuar, sepse pas katër muajsh isha përsëri shtatzënë", ka thënë nëna e Moise Kean, Isabelle. Jeta e familjes "Kean" ndryshoi kur Moise nënshkroi kontratën e tij të parë profesionale me Juventusin: "Kishim shumë pak para në shtëpi. Një ditë, teksa ora shënonte 05:30 e mëngjesit, im bir, Moise, më telefonoi derisa po shkoja në punë. Fillimisht u frikësova, mendova se diçka i kishte ndodhur atij, që më merre në një orë të tillë, por më tha: Mami, kam një surprizë për ty. Unë e pyeta plot ankth: Mos më thuaj që nuk ke nënshkruar me Juven. Dhe ai m'u përgjigj: Jo,

mami, kam nënshkruar dhe ju nuk do të punoni më, pasi do të vini të jetoni në Torino me mua". Djaloshi i talentuar i nxori nga varfëria, ku po "notonin" gjithë kohës. Kjo është arsyeja pse Isabelle e falënderon Juventusin që po punon për rinovimin e kontratës me Mino Raiola, për ta shmangur humbjen e Kean në afatin e caktuar, vitin 2020: "Juve e mirëpriti atë si një fëmijë, e bëri njeri. E ndihmoi të studionte dhe të stërvitej, e rriti atë në çdo drejtim. E bëri ky që është jo vetëm në fushë, por edhe në jetën si njeri. Klubi bardhezi ishte si babai i tij". Së fundi, nëna e yllit të ri të Joves dhe Italisë konfirmon dëshirën e madhe të Kean, edhe brenda katër mureve të shtëpisë, ku nuk heq dorë nga "shoku" i tij më i mirë: "I jep atij një top dhe e bën të lumtur. Moise është i palodhur. Edhe pas një dite trajnimi, ai kthehet në shtëpi dhe gjëja e parë që bën është të driblojë me topin. Problemi është se më përfshin dhe mua, më do si rivale, kur argëtohet me topin...". Siç përmend "Tuttosport", Juventus po përpiqet ta "blindojë" Moise Kean, sepse xhevahirin e ri po e lakmojnë disa klube, mes të cilëve Ajaxi dhe Milani.

## Lakersat mposhtin me vështirësi Sacramenton

LOS ANGELES, 25 MARS - Janë luajtur katër ndeshjet e radhës të kampionatit të basketbollit në NBA. New Orleans është mundur në shtëpi nga Houston Rocketsi me rezultatin 90-113. Mysafirët ishin ata që dominuan në tre perioda të ndeshjes, duke mos e diskutuar asnjëherë fitoren. Hardeni me 28 pikë ishte më i miri në parket për Houstonin, ndërsa Jacksoni me 19 pikë nuk mjaftoi për Orleansin. Aldridge me 48 pikë e 13 rebaunde i ka dhënë fitoren Sant Antonio Spursit në transfertën e Boston Celticsit, me ndeshjen që përfundoi me rezultatin 96-115 për mysafirët. Këta të fundit morën kryesimin e lojës që në periodën e parë, duke dominuar gjatë gjithë takimit. Me këtë fitore San Antonio mban vendin e tetë në renditje, duke kapur një vend në "play-off", ndërsa Bostoni e ka siguruar prej kohësh një vend në "play-off" në



konferencën e lindjes. Golden State ka fituar në shtëpi ndaj Detroitit me rezultatin 121 me 114, në një ndeshje me emociione dhe rivalitet deri në fund. Ishin vendësit që fituan tri perioda e para, ndërsa miqtë u përpoqën të bënin diçka në periodën e katërt, duke ngushtuar rezultatin, por nuk arritën ta thyenin Warriorsin. Curry realizoi 26 pikë, ndërsa Thompsoni 24, duke i

dhënë fitoren Golden States, ndërsa për miqtë mbetën për statistikë 24 pikët e Griffinit. Los Angeles Lakersi ka mundur me vështirësi Sacramento Kingsin me rezultatin 111-106. Një ndeshje emocionuese ku miqtë fituan dy perioda, por vendësit kishin thelluar rezultatin në dy periodat e tjera. Jamesi dhe Kuzma realizuan nga 29 pikë secili për Lakersin, duke u dhënë në fund fitoren.

### SHKURT

#### Pogba, mes Realit dhe Juventusit

Mesfushori i Francës, Paul Pogba, ka vendosur ta largohet nga Manchester Unitedi. Rrëfimi i fundit i Paul Pogbas, se është ëndërr e çdokujt të luajë për Real Madridin me Zinedine Zidanen në stol, ishte një lëvizje e menduar për të sugjeruar se ai është i hapur për t'iu bashkuar gjigantit spanjoll, shkruan e përditshmja spanjolle "AS". Pogba dëshiron të largohet nga Premierliga pas tre vjetëve qëndrim në "Old Trafford". Ai u përpoq të largohet gjatë afatit kalimtar dimëror, pas marrëdhënieve të këqija me trajnerin e atëhershëm Jose Mourinhon dhe flitej se mund të kalonte në Barcelonë. Tash Realit është favorit për t'i siguruar shërbimet e francezit, por edhe ish-klubi i tij Juventus dëshiron ta rikthejë Pogban në Torino.

#### Tucheli e ka besimin e PSG-së

Mediet në Francë raportojnë se Thomas Tuchel do ta zgjasë kontratën, pavarësisht faktit se Paris Saint-Germaini është eliminuar në Ligën e Kampionëve nga Manchester Unitedi. Klubi parisien beson se trajneri aktual është një zgjidhje e mirë në afat të gjatë, andaj janë të gatshëm t'i besojnë atij. Madje raportohet se palët kanë arritur marrëveshje për vazhdimin e bashkëpunimit deri në vitin 2021. PSG-ja është në rrugë për ta fituar titullin tjetër të kampionatit të Francës dhe shpallja e vendimit për zgjerimin e bashkëpunimit me ekspertin gjerman pritet në ditët në vijim. Pos vazhdimit të kontratës, Tuchel do të ketë edhe rritje të dukshme në pagën e tij.

#### Christenseni: Hazardi mund të qëndrojë te Chelsea

Real Madridi është duke u interesuar për transferimin e Eden Hazardit në afatin kalimtar të verës. Mbrojtësi i Chelseat, Andreas Christensen, ka bërë me dije se belgu mund të qëndrojë te skuadra londineze, përkundër dëshirës së tij që të kalojë në "Santiago Bernabeu". "Ai (Eden Hazard) është një lojtar shumë i rëndësishëm për ne dhe kjo gjë tashmë dihet. Unë mendoj se ai do të qëndrojë me ne edhe sezonin e ri, por në futboll mund të ndodhë gjithçka. Klubi e dëshiron qëndrimin e tij, andaj unë nuk mund të them më shumë rreth së ardhmes së tij", ka thënë Christensen.

#### Liverpooli, gati ta shesë Keitan

Skuadra e Liverpoolit po vlerëson mundësinë për të larguar në fund të sezonit mesfushorin Naby Keita, i cili u transferua me bujë të madhe nga Leipzigu, që përfitoi plot 52 milionë pandë pas insistimit të Jurgen Kloppit. Afrikani ka bërë një prezantim të dobët në 27 ndeshjet e fundit me Liverpoolin, duke mos shënuar asnjë gol dhe prania e tij në fushë thuhet se asnjë çast nuk ka bërë diferencën. Drejtuesit e klubit anglez janë gati ta shesin mesfushorin për 40 milionë paundë, kurse ai pëlqehet nga Bayerni dhe Dortmundi.

#### Umtiti: Te Barça ka vend për Griezmannin

Samuel Umtiti dhe Antoine Griezmann janë miq shumë të mirë, luajnë së bashku te kombëtarja franceze dhe mund ta bëjnë diçka të tillë edhe në klub. Barcelona është rikthyer të interesohet për sulmuesin e Atletico së Madridit. Griezmanni refuzoi në verën e kaluar dhe rinovoi me "colchoneros" deri në vitin 2023. Megjithatë, ai ka ndryshuar mendim dhe dëshiron të transferohet në Katalunjë në fund të sezonit. Kjo gjë e lumturon mbrojtësin e Barçës, i cili komenton këtë transferim të mundshëm në konferencën për shtyp përpara ndeshjes së kampionëve të botës kundër Islandës. "Nuk kam biseduar me Antoine për këtë gjë, por do të isha i lumtur nëse do të vinte te Barcelona. Jemi miq dhe do të më pëlqente shumë. Sigurisht që te Barcelona ka vend për një lojtar si ai. Ndonjëherë, në një karrierë, ka disa zgjedhje që duhen bërë dhe për të cilat pendohesh më vonë", ka thënë Umtiti.





UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY  
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Rektor: Prof. Doc. Dr. Bajram Kosumi Ref.br.01/375, dana 25.03.2019

Shodno odredbama čl.8 Zakona o radu br.03/L.-212, odredaba čl.26 Zakona o visokom obrazovanju Kosova br.04/L-037, kao i čl.48 st.1.3 Privremenog Statuta Univerziteta "Kadri Zeka" u Gnjilanu, Senat UKZ na sednice XXI i XXIX, održane dana 19.04.2018 i 05.03.2019 godine, doneo je odluku za objavljivanje:

## K O N K U R S A

Za izbor akademskog osoblja u akademskim jedinicama Univerziteta "Kadri Zeka" u Gnjilanu, za akademsku godinu 2019/2020.

### Pedagoški fakultet

1. Nastavnik predmeta: Albanski jezik, Poznavanje fonetike sa fonologijom, Morfologija albanskog jezika, Sintaksa albanskog jezika.
2. Nastavnik predmeta: Psihologija deteta, Psihologija vaspitanja, Psihologija ličnosti, Psihologija razvoja i ličnosti, Psihologija igre.
3. Nastavnik predmeta: Pedagogija predškolskog vaspitanja i obrazovanja, Strategija predškolskog vaspitanja i obrazovanja, Teškoće u učenju, Komunikacija u obrazovanju, Rad sa talentiranom decom.
4. Nastavnik predmeta: Sveobuhvatna-inkluzivna metodologija obrazovanja, Teorija učenja, Savremene tendencije-nastojanja u obrazovanju, Razvoj kurikula.
5. Nastavnik za grupu predmeta iz matematike.

### Ekonomski fakultet

6. Dva nastavnika za grupu predmeta iz menadžmenta.
7. Jedan nastavnik za grupu predmeta iz finansija i računovodstva.
8. Jedan nastavnik za engleski jezik.

### Pravni fakultet

9. Jedan nastavnik gradanskog prava.
10. Jedan nastavnik krivičnog prava.
11. Jedan nastavnik predmeta: Ekonomije, Ekonomske politike, Međunarodne finansijske institucije, Međunarodno ekonomsko pravo, Potrošnja i pravo potrošača.
12. Jedan nastavnik predmeta: Upravni postupak, Izborni sistemi, Pravna administrativna klinika, Lokalni izbori, Lokalna uprava i demokratsko društvo, Čuvanje informacija.

### Fakultet računarstva

13. Jedan nastavnik predmeta: Izrada veb aplikacija, Napredni veb dizajn, Analiza poslovnih informacija, Veb tehnologije, Veb usluge, Multimedijalni dizajn.
14. Jedan nastavnik predmeta: Uvod u kompjutersku grafiku, Vizualizaciju i obradu slike, SEW i IE projekat, Razvoj interneta, Uvod u veštačku inteligenciju, ICT za predškolsko obrazovanje.

### Kandidati koji se pojave na konkursu moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zahtev
- Biografiju (CV)
- Kopiju diplome o završenim studijama, magistarskih i doktorskih studija, overena
- Certifikat sa ocenama na tri nivoa studija
- Izvod iz matične knjige rođenih
- Potvrdu o državljanstvu (ili potvrdu prebivališta u R. Kosovo)
- Dokaz(kopije) za naučne radove, monografije, udbenike, publikacije u međunarodnim naučnim ili umetničkim časopisima, aktivno učešće na domaćim i međunarodnim konferencijama, itd.
- Dokaz o iskustvu nastavničkog rada i drugih profesija u oblasti nastave u visokom obrazovanju;
- Dokaz da se protiv njega ne vodi istraga.
- Dokaz o poznavanju stranog jezika.

Kandidati koji su završili bachelor studije ili magistraturu u inostranstvu moraju dostaviti dokaze o nostrifikaciji diplome od strane MONI-a.

Kandidati treba da donesu jedan od ovih dokumenata kao dokaz o poznavanju stranog jezika:

1. Da su završili jedan od nivoa studija stranih jezika ili certifikat IELTS, TOEFL, ili bilo koji drugi važeći dokument.

Kandidati moraju ispunjavati sve uslove utvrđene Privremenim statutom Univerziteta "Kadri Zeka" u Gnjilanu, posebno onima predviđenim čl.155, 156 i 157 ovog Statuta (vidi: <http://uni-gjilane.net/relevantni dokumenti/>)

### Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u novinama.

Podnošenje dokumenata: Zahtev se protokolishc u kancelariju br.4, dok celokupna dokumentacija se predaje u kancelariji za akademska pitanja br.3.

Aplikacije koje stignu nakon isteka roka kao i nekompletirane aplikacije neće se razmotriti uopšte. Konkurs možete naći na zvaničnom sajtu univerziteta: <http://www.uni-gjilan.net>



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY  
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Rektor: Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi Ref.nr.01/375 25/03/2019

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L.-212, dispozitat e nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, Nr. 04/L-037, si dhe nenit 48, paragrafi 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan dhe bazuar në vendimet e miratuara nga Senati në mbledhjet XXI dhe XXIX, të mbajtura më datë 19.04.2018 dhe 05.03.2019, Senati i Universitetit merr vendim për të shpallur:

## K O N K U R S

Për zgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, për vitin akademik 2019/2020.

### Fakulteti i Edukimit

1. Një mësimdhënës për lëndët: Gjuhë shqipe, Njohuri për gjuhën-fonetikë me fonologji, Morfologji e gjuhës shqipe, Sintaksë e gjuhës shqipe.
2. Një mësimdhënës për lëndët: Psikologji e fëmijës, Psikologji e edukimit, Psikologji personaliteti, Psikologji e zhvillimit dhe personalitetit, Psikologji e lojës.
3. Një mësimdhënës për lëndët: Pedagogji e edukimit parashkollor, Strategji e edukimit parashkollor, Vështirësitë në të nxënë, Komunikimi në edukim, Puna me fëmijë të talentuar.
4. Një mësimdhënës për lëndët: Metodologji e edukimit gjithëpërfshirës, Teori e mësimit, Tendencat bashkëkohore në arsim, Zhvillimi i kutikulave.
5. Një mësimdhënës për grup lëndësh nga matematika.

### Fakulteti Ekonomik

6. Dy mësimdhënës për grup lëndësh nga menaxhmenti.
7. Një mësimdhënës për grup lëndësh nga financat dhe kontabiliteti.
8. Një mësimdhënës për gjuhë angleze.

### Fakulteti Juridik

9. Një mësimdhënës për lëndë nga fusha: juridike – civile.
10. Një mësimdhënës për grup lëndësh nga fusha: juridike – penale.
11. Një mësimdhënës për lëndët: Ekonomia, Politika ekonomike, Institucionet financiare ndërkombëtare, E drejta ndërkombëtare ekonomike, Konsumi dhe e drejta e konsumatoreve.
12. Një mësimdhënës për lëndët: Procedurë administrative, Sistemet elektorale, Klinika juridike administrative, Zgjedhjet lokale, Qeverisja lokale dhe shoqëria demokratike, Ruajtja e informacionit.

### Fakulteti i Shkencave Kompjuterike

13. Një mësimdhënës për lëndët: Zhvillimi i ueb-aplikacioneve, Ueb dizajn i avancuar, Analiza e informacionit të biznesit, Ueb teknologjitë, Shërbimet e bazuara në ueb, Dizajnim i multimedia.
14. Një mësimdhënës për lëndët: Hyrje në grafikën e kompjuterëve, Vizualizimi dhe procesimi i imazheve, Projekti në SEW dh IE, Zhvillimet për internet, Hyrje në inteligjencë artificiale, TIK për edukim parashkollor.

### Kandidatët të cilët paraqiten në konkurs duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Kërkesën;
- Biografinë (CV) ;
- Kopjen e diplomës të studimeve themelore, masterit dhe doktoraturës, të noterizuara;
- Certifikatën e notave në tri nivelet e studimit;
- Certifikatën e lindjes;
- Certifikatën e shtetësisë (ose certifikatën për vendbanimin në Republikën e Kosovës) ;
- Dëshmi (kopjet) për punimet shkencore, monografive, teksteve mësimore, publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare etj.
- Dëshmi për përvojën e punës në mësimdhënie dhe profesione tjera lidhur me fushën e mësimdhënies në arsimin e lartë;
- Dëshmi se ndaj tij nuk zhvillohen hetime;
- Dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore.

Kandidatët që kanë doktoruar ose kanë përfunduar studimet bachelor apo master jashtë vendit duhet të sjellin dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i .

Kandidatët duhet të sjellin njërin prej këtyre dokumenteve si dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore:

1. Të kenë të kryer njërin nivel të studimeve në gjuhën e huaj ose certifikatë IELTS, TOEFL apo ndonjë dokument tjetër të vlefshëm.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me Statutin e Përkohshëm të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, në veçanti ato që parashihen në nenin 155,156 dhe157 të këtij Statuti (shih: <http://uni-gjilan.net/dokumente-relevante/>) dhe Rregullores në fuqi për zgjedhjen e personelit akademik në UKZ.

### Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në gazetë.

Paraqitja e dokumenteve: Kërkesa protokolohet në zyrën nr.4, kurse i tërë dokumentacioni dorëzohet në zyrën për çështje akademike, nr. 3.

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim. Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në ueb faqen zyrtare të universitetit: <http://www.uni-gjilan.net>




**UNIVERSITETI I GJAKOVËS "FEHMI AGANI"**

Rr. Ismail Qemali, pn 50 000 Gjakovë, Republika e Kosovës  
Tel: 038 200 20 831 E-mail: rektorati@uni-gjk.org  
Web: www.uni-gjk.org

Nr. Prot: 01/59  
Datë 25/03/2019

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, Udhëzimit Administrativ 7/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe nenit 48 paragrafi 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", Senati UGJFA-së në mbledhjen e mbajtur me datë 11.03.2019, mori vendim për të shpallur:

**KONKURS**

për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e Universitetit të Gjakovës

**I. FAKULTETI I EDUKIMIT**

**Programet: Edukimi Parashkollor dhe Edukimi Fillor**

- Një (1) mësimdhënës për lëndët: Gjuhë shqipe në Edukimin Fillor III, Metodologji e Gjuhës shqipe (Programi Parashkollor dhe Fillor)
- Një (1) mësimdhënës për grup lëndësh nga: Matematika (Programi Parashkollor dhe Fillor)
- Një (1) mësimdhënës për grup lëndësh nga: Pedagogjia (Programi Parashkollor dhe Fillor)
- Një (1) mësimdhënës për grup lëndësh nga: Psikologjia (Programi Parashkollor dhe Fillor)
- Një (1) mësimdhënës për lëndët: Fëmijët me mësim në natyrë, Edukatë shëndetësore, Edukim mjedisor (Programi Fillor dhe Parashkollor)
- Një (1) mësimdhënës për lëndët: Metodologjia e arteve figurative, Punë dore me modelim (Programi Parashkollor dhe Fillor)
- Një (1) asistent për grup lëndësh nga: Histori kombëtare, Bazat e shkencave shoqërore me metodologji, Metodologji e shkencave shoqërore, Edukatë qytetare (Programi Parashkollor dhe Fillor)
- Një (1) asistent për grup lëndësh nga: Gjuha shqipe dhe Metodologji e Gjuhës shqipe (Programi Parashkollor dhe Fillor)
- Një (1) asistent për grup lëndësh nga: Matematika (Programi Parashkollor dhe Fillor)
- Një (1) asistent për grup lëndësh nga: Psikologjia (Programi Parashkollor dhe Fillor)

**II. FAKULTETI I MJEKËSISË**

**Programet: Infermieri dhe Mami**

- Një (1) mësimdhënës për lëndët:
  - Biokimi, Biofizikë, Farmakologji
  - Shkencat natyrore dhe farmakologji
  - Programi diagnostikë terapeutike
- Një (1) mësimdhënës për lëndët:
  - Obstetrika me Gjinekologji
  - Shëndeti i gruas
  - Infeksioni në shtatzëni në periudhën perinatale
  - Siguria e barnave gjatë shtatzënisë dhe laktacionit.
- Një (1) mësimdhënës për grup lëndësh profesionale në programet Infermieri dhe Mami
- Katër (4) asistentë për grup lëndësh profesionale në programet Infermieri dhe Mami

**III. Kushtet e përgjithshme**

- Zgjedhja e personelit akademik do të behet në pajtim me dispozitat e Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", Udhëzimit Administrativ (MPMS) 7/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik dhe vendimin e Senatit të UGJFA-së nr. 01/160/1 të dt. 28.02.2018.
- Kandidatët të cilët aplikojnë për mësimdhënës duhet t'i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 157 paragrafi 1 të Statutit të përkohshëm të UGJFA-së, dhe atë:
  - të kenë gradën e doktorit të shkencës
  - për II. 3 duhet të kenë përfunduar shkollimin baçelor dhe master në Infermieri, respektivisht Mami dhe të kenë gradën Doktor shkence në fushën e mjekësisë (preferohet në Infermieri ose Mami)
  - të kenë numër të zgjedhur të punimeve të publikuara në revista ndërkombëtare shkencore, me së paku një punim kryesor të publikuar dhe të shqyrtuar në revista ndërkombëtare
  - të tregojnë aftësi për mësimdhënie
  - të kenë së paku tri vite përvojë pune në procesin mësimor në Universitet.
- Kandidatët që aplikojnë për asistent duhet të plotësojnë kushtet e parapara me nenin 159, paragrafi 1 dhe 2, të Statutit të Përkohshëm, dhe atë:
  - të kenë të përfunduar me sukses studimet master në drejtimin përkatës
  - të jenë jo më të vjetër se 30 vjet kur emërohen për herë të parë
  - të kenë notën mesatare jo me pak se 8 në studimet baçelor dhe në ato master.

**IV. Dokumentet e nevojshme për aplikim**

- Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:
  - kërkesën për aplikim dhe biografinë (CV)
  - certifikatën e lindjes (origjinale) jo më të vjetër se 6 muaj dhe kopjen e letërnjoftimit
  - diplomat origjinale ose kopjet e diplomave përkatëse (për pozitën e mësimdhënësit diploma e tri niveleve të studimeve, ndërsa për pozitën e asistentit diploma për dy nivelet e studimit dhe pasqyrën e notave) të vërtetuara nga noteri
  - kandidatët që kanë mbaruar studimet jashtë vendit duhet të sjellin edhe vendimin për nostrifikimin e diplomës përkatëse (baçelor, master, magjistraturë, doktoratë). Nuk do të merret në konsideratë dëshmia e aplikimit për nostrifikim

- dëshmitë për monografite dhe publikimet shkencore e profesionale në revista ndërkombëtare shkencore brenda kornizës së përcaktuar me Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 1/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension (e plotësuar me Udhëzimin Administrativ 7/2018) dhe vendimin e Senatit të UGJFA-së nr. 01/160/1 të datës 28.02.2018
- dëshmi nga organet kompetente që nuk janë në hetime ose nuk janë dënuar për ndonjë vepër penale (origjinale)
- dëshmi mbi përvojën e punës në mësimdhënie
- si dhe informata tjera shtesë, të cilat janë të rëndësishme për ata që aplikojnë.

- Kandidatët të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës duhet t'i paraqesin edhe këto dokumente shtesë:
  - leje qëndrimin apo lejen e punës në Republikën e Kosovës (të noterizuar)
  - dëshmi origjinale nga institucioni relevant në vendin e origjinës (p.sh Administrata Tatimore) që nuk kanë marrëdhënie të rregullt të punës në vendin e tyre të origjinës.

**V. Kohëzgjatja e emërimit dhe kufizimet për emërim**

- Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen në përputhje me dispozitat përkatëse të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Gjakovës.
- Kriteri i moshës i përcaktuar në nenin 159 të Statutit të Përkohshëm të UGJFA-së do të merret në konsideratë deri në ditën e përmbylljes së konkursit. Nëse një kandidat ka qenë i angazhuar në Universitetin e Gjakovës në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm apo me honorar para moshës së përcaktuar sipas nenit 159 të Statutit, kjo nuk nënkupton që për të njëjtin nuk aplikohet kriteri i moshës së paraparë me Statut në momentin e themelimit të marrëdhënies së rregullt të punës.
- Në Universitetin e Gjakovës nuk lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve brenda ndonjë prej njësive akademike (fakulteteve), nëse brenda të njëjtës njësi akademike kanë një marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjar të ngushtë.
- Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi në Republikën e Kosovës themelojnë marrëdhënie pune sipas Ligjit të punës, nën kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë për punësimin e shtetasve të huaj dhe sipas konventave ndërkombëtare.

**VI. Vendimi, periudha e ankimit dhe e përmbylljes së konkursit**

- Kandidatët të cilët janë të pakënaqur me vendimet e organeve kompetente të njësive akademike, përkatësisht Senatit të UGJFA-së, gjatë procesit të përzgjedhjes së personelit akademik, kanë të drejtë ankese në dy faza:
  - Faza e parë e ankimit është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit të Buletinit në ueb-faqe të UGJFA-së. Buletini do të qëndrojë i publikuar 15 ditë në ueb-faqe të UGJFA-së. Ankesa duhet të dorëzohet në njësive akademike përkatëse dhe do të shqyrtohet nga këshilli i njësive akademike brenda 15 ditësh nga dita e përmbylljes së afatit të ankimit. Raporti përfundimtar pas shqyrtimit të ankesave i dërgohet për njoftim Komisionit të Studimeve lidhur me rregullsinë e procedurës dhe propozimeve nga fakultetet.
  - Faza e dytë e ankimit bëhet ndaj vendimit të Senatit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas pranimit në dorëzim të vendimit. Ankesa duhet t'i drejtohet Komisionit të Senatit për ankese dhe parashtrës, që shërben si instancë e fundit e ankimit në UGJFA. Ankesa duhet të jetë e qartë dhe konkrete, duhet të përfshijë të gjitha argumentet relevante dhe arsyeshmërinë e kontestimit të vendimit. Raporti i ankesave të shqyrtuara nga Komisioni i ankesave i prezantohet Senatit për vendosje përfundimtare në nivel të UGJFA-së. Propozimi i Komisionit të Senatit për ankese dhe parashtrës nuk ka karakter obligativ për Senat.
- Pala ankuese do të njoftohet me shkrim lidhur me vendimin përfundimtar të Senatit.
- Konkursi për emërim të personelit akademik, duhet të përmbyllet me vendime përkatëse të Senatit të UGJFA-së për të gjitha vendet e shpallura, në një periudhë jo më të gjatë se 175 ditë nga dita e shpalljes.
- Për raste të veçanta, para arritjes së propozimit në Senat, me kërkesë të Rektorit afati i të gjithë procedurës mund të zgjatet edhe maksimum për 30 ditë.

**VII. Mënyra e aplikimit**

- Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë fizike dhe elektronike (CD).
- Dokumentacioni në formë fizike dhe elektronike (CD) duhet të dorëzohet në Fakultetin përkatës, përkatësisht për:
  - Fakultetin e Edukimit në adresën "Normalja e Gjakovës" pn., 50000 Gjakovë
  - Fakultetin e Filologjisë në adresën "Normalja e Gjakovës" pn., 50000 Gjakovë
  - Fakultetin e Mjekësisë në adresën "Mit'hat Frashëri" pn., 50000 Gjakovë
- Punimet shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare nuk ka nevojë të skanohen në tersi, por vetëm faqja e parë dhe e fundit e punimit (përfshirë konkluzionet), ndërsa për libra të botuar duhet të skanohen faqja e parë e librit dhe faqja në të cilën shihet katalogimi në botim (CIP).
- Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara, si dhe ato që nuk deponohen të skanuara përmes postës elektronike (me CD), nuk do të merren në shqyrtim.
- Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes në gazetë, përkatësisht nga data 26.03.2019 deri më datën 09.04.2019.
- Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në ueb-faqen e universitetit <http://www.uni-gjk.org>
- Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni Administratën e Fakulteteve përkatëse, prej orës 09:00 – 16:00
  - për Fakultetin e Edukimit në numrin e tel: 038 200 20 835
  - për Fakultetin e Filologjisë në numrin e tel: 038 200 20 836 ose 049 940 431
  - për Fakultetin e Mjekësisë në numrin e tel: 038 200 20 849.









**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSLOVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër: 93 /1  
Datë: 25.03.2019

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (Gaz. Zyrtarë e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës të dt. 18.03.2019 me nr. 256/19 së shkollës Sh M L T "11 Marsi", në Prizren shpall:

### Ftesë për ofertë

**Për ekskursion të maturantëve të ShMLT „11 MARS” në Prizren, në Republikën e Shqipërisë**  
**Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjencionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarfë të mbyllur.**

**Agjencioni turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:**

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së.
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfört dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës "D";
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësit;
- Agjencioni duhet të ketë një dëshmi për marrëveshje me hotelin ku mendon me i derguar nxënësit ( **KA të klasëve të 12-ta e ka preferuar javën e fundit të muajit Prill**)
- Agjencioni duhet të prezantojë dëshmi: meynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskursionit.
- Agjencioni turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës
- Agjencioni duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike.
- Agjencioni duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do tu bëhen monumenteve kulutor-historike.
- Agjencioni do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit (2016-2017-2018)
- Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskurzion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskursion.
- Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara!

#### Kushtet tjera:

- Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimeve nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë,
- Pamvaresisht numrit të nxënësve për paralele, kujdestarët e klasave shkojnë falas në ekskursion,
- Hoteli të posedojë sallë për ballo,
- Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner),
- Mundësi vizite në qytetet: Tiranë, Durrësi i vjetër, Shkodër, Krujë, Berat, Vlorë etj.

#### Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e AAAPARr në Prishtinë.

Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi më i ulët ofertues (Lartësia maximale e vendosur nga KDSH është 100 Euro)
- Lloji i Hotelit (kategoria, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
- Menyja
- Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
- Gjendja teknike e autobusëve
- Referencat

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfutjesit do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje të shkollës.

Aplikuesit e interesuar ofertat e veta duhet t'i paraqesin në dy zarfë (në zarfën e vogël oferta e mbyllur e futur në zarfën e madhe e cila përmban dokumentacionet e kërkuara nga shkolla). Ofertat dorëzohen në zyret e AAAPARr në Prishtinë (Rruga „Agim Ramadani” p.n. nderta MASHT-i II, në katin e tretë, në objektin përball Fakultetit Ekonomik dhe Juridik në Prishtinë)

Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus një ditë), ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

**Afati i paraqitjes së ofertave është shtatë ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore.**



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance  
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



### Njoftim nga Administrata Tatimore e Kosovës

#### Regjistroni veprimtaritë ekonomike dhe deklaroni të punësuarit tuaj!

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjithë personat të cilët merren me aktivitete afariste, se në bazë të legjislacionit tatimor janë të detyruar të regjistrohen, pajisen me Numër Unik Identifikues / Numër Fiskal, deklarojnë dhe paguajnë tatimet (bazuar në statusin e tyre) dhe të mbajnë Tatimin në Burim dhe Kontributet Pensionale për punëtorët e tyre. Po ashtu, ATK, rikujton të gjithë personat që zhvillojnë veprimtarisë ekonomike ta kenë në harmoni me Kodin e Veprimtarive Ekonomike NACE Rev.2, si dhe të kenë të hapura llogaritë përkatëse tatimore.

Disa nga tatimpaguesit me veprimtaritë në vijim, nuk zbatojnë këtë obligim, prandaj ATK u bënë thirrje që të regjistrohen apo përditësojnë të dhënat e tyre sa më parë dhe të përmbushin të gjitha obligimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor.

Gjithashtu ATK, ju njofton se aktivitetet e sajë, do të përqendrohen pikërisht te këto veprimtari, prandaj, ju inkurajon që t'i përgjigjeni detyrimeve tatimore, në mënyrë që të mos bëheni subjekt i ndëshkimeve të përcaktuara me Ligj.

Ndërtimtaria	Tregtia	Shërbimet profesionale, artistike dhe zbavitëse	Patundshmëritë / Qiradhënësit	Agrikulturë dhe mineraleve	Punëdhënësit që nuk regjistrojnë punëtorët
